



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AGJENCIA  
E SIGURIMIT  
TË DEPOZITAVE

**RAPORTI VJETOR**

**2019**

[www.asd.gov.al](http://www.asd.gov.al)  
t: +355 (4) 2362 989/2347 298  
f: +355 (4) 2362 984  
e: [info@asd.gov.al](mailto:info@asd.gov.al)  
Rruga e Elbasanit, Nr. 317, Tiranë



## TRYEZA E LËNDËS

Seksioni 1 – Rreth këtij Raporti .....	4
1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm.....	5
1.2. Përmbledhje Ekzekutive.....	9
Seksioni 2 - Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe vënia në zbatim e rekomandimeve të saj nga Agjencia.....	11
Seksioni 3 – Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri dhe zhvillimet gjatë vitit 2019.....	18
3.1. Depozitat në sistem.....	20
3.2. Sigurimi i depozitave në banka.....	22
3.2.1. Depozitat e sigurueshme në sistemin bankar.....	22
3.2.2. Depozitat e sigurueshme të individëve.....	25
3.2.3. Depozitat e siguruar të individëve.....	27
3.2.4. Depozitat e sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare.....	29
3.2.5. Depozitat e siguruar të tregtarëve e shoqërive tregtare.....	30
3.3. Sigurimi i depozitave në SHKK.....	31
3.3.1. Depozitat e sigurueshme në SHKK.....	32
3.3.2. Depozitat e siguruar në SHKK.....	34
3.4. Procesi i verifikimit të subjekteve anëtare të skemës.....	36
Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të Agjencisë.....	38
4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka.....	38
4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka.....	38
4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka.....	38
4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruar në banka.....	40
4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në SHKK.....	41
4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.....	41
4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.....	41
4.3. Administrimi i mjeteve dhe burimeve financiare.....	44



4.3.1.	Marrëveshjet për shërbimin e kujdestarisë dhe ndërmjetësimit të titujve në monedhë të huaj. ....	46
4.3.2.	Marrëveshja e huasë me BERZH. ....	47
Seksioni 5 – Angazhimi me depozituesit dhe partnerët. ....		48
5.1.	Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut. ....	48
5.2.	Bashkëpunimi me institucione të sistemit bankar dhe financiar në vend. ....	52
5.3.	Bashkëpunimi rajonal. ....	53
5.3.1.	Takimi i 7-të rajonal i EFDI Ballkan. ....	53
5.3.2.	Vizita në Tiranë e Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës. ....	54
5.3.3.	Vizita në Fondin e Sigurimit të Depozitave të Malit të Zi. ....	54
5.4.	Bashkëpunimi ndërkombëtar. ....	55
5.4.1.	Pjesëmarrja në forumet ndërkombëtare. ....	55
5.4.2.	Takimi i Komitetit Rajonal të Evropës dhe seminari teknik në Tiranë. ....	57
5.4.3.	Marrëveshjet e Bashkëpunimit. ....	58
5.4.4.	Shkëmbimi i eksperiencave me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Ukrainës. ....	59
Seksioni 6 – Mirëqeverisja e organizatës ....		60
6.1.	Këshilli Drejtues ....	60
6.2.	Struktura organizative ....	62
Seksioni 7 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. ....		63
Seksioni 8 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. ....		70
8.1.	Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. ....	70
8.2.	Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. ....	72



## Seksioni 1 – Rreth këtij Raporti

Ky Raport Vjetor ofron një panoramë të veprimtarisë financiare dhe administrative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për periudhën 1 Janar 2019 deri në 31 Dhjetor 2019. Raporti pasqyron aktivitetet dhe iniciativat kryesore, duke synuar që të gjithë përfituesit e skemës së sigurimit të depozitave, bashkëpunëtorët, partnerët dhe publiku të informohen mbi parimet mbi të cilat është ngritur skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri dhe angazhimin e Agjencisë si administratore e saj për të krijuar sa më shumë vlerë. Ky Raport Vjetor është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me Ligjin nr. 39/2016 dhe Ligjin nr. 132/2016, Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik miratuar me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 134/2018, datë 20.12.2018, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë.

Pasqyrat financiare pasqyrojnë pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2019 si dhe performancën e saj financiare e flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë. Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF-të”). Bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë auditohen dhe certifikohen nga auditues të jashtëm të specializuar.

Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Këshilli Drejtues ka ushtruar tagrat që i jep Ligji për t’u siguruar që Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën dhe administrimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave gjatë vitit në raportim.

Jeni të lutur të jepni komentet tuaja për Raportin Vjetor 2019 në adresën [info@asd.gov.al](mailto:info@asd.gov.al). Ky Raport Vjetor, si dhe raportet vjetore të mëparshme, mund të konsultohen në faqen tonë zyrtare të internetit [www.asd.gov.al](http://www.asd.gov.al).



### **1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm.**


Të nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë t'ju paraqesim raportin vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2019. Ky raport synon të paraqesë në mënyrë të përmbledhur zhvillimet dhe arritjet kryesore që kanë karakterizuar aktivitetin tonë përgjatë këtij viti. Gjithashtu, në raport mund të informoheni mbi ecurinë e depozitave në banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit për këtë vit, ashtu si dhe mbi treguesit kryesorë të skemës së sigurimit të depozitave.

Ndonëse treguesit e skemës së sigurimit të depozitave kanë vijuar edhe këtë vit të jenë mjaft pozitive, ne sërish besojmë se gjithmonë ka hapësirë për përmirësim. Për këtë arsye, edhe gjatë këtij viti kemi qenë të angazhuar maksimalisht në zhvillimin e kapaciteteve dhe standardeve të skemës së sigurimit të depozitave për të qenë më afër depozituesve shqiptarë, për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të qenë vigjilentë dhe të gatshëm për të kompensuar në rast nevojë. Edhe pse skema shfaqet e fortë dhe me tregues në rritje, jemi të ndërgjegjshëm se na duhet të vazhdojmë përpjekjet tona në çdo moment në drejtim të përmbushjes me efektivitet të mandatit tonë ligjor.

Ashtu si dhe në vitet e tjera, një element thelbësor i veprimtarisë së Agjencisë edhe për këtë vit ka qenë rritja e gatishmërisë operationale për një ngjarje të mundshme kompensimi. Për këtë qëllim, kemi kryer simulime të përgjithshme me pjesëmarrjen e bankave Agjente, si dhe simulime teknike me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Në eksperiencën tonë, këto ushtrime simulimi kanë një rëndësi të veçantë edhe për faktin se na lejojnë të identifikojmë gabime apo mangësi në proceset tona, t'i identifikojmë si dhe t'i korrigjojmë ato në kohë të qeta. Në kuadër të përgatitjes për kompensim, stafi jonë ka zhvilluar vizita pune institucionet homologe në Mal të Zi dhe Ukrainë, për të mësuar nga eksperiencat e kompensimit në këto dy vende, e veçanërisht vështirësitë dhe mësimet e nxjerra nga secili prej tyre. Besojmë se kjo do të na ndihmojë në të ardhmen të jemi më të përgatitur në një proces kompensimi të shpejtë dhe eficient.

Në kuadër të bashkëpunimit tonë të konsoliduar me Korpusin Vullnetar për Shërbime Financiare (FSVC) dhe në zbatim të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar, këtë vit arritëm të kryenim



një ushtrim vetëvlerësimi të skemës sonë në raport me Parimet Bazë të Sigurimit të Depozitave të IADI, me ndihmën e ekspertëve të dërguar nga FSVC. Parimet Bazë të IADI-t përdoren nga autoritetet ndërkombëtare financiare si pjesë e programeve për të vlerësuar gjendjen e sistemit financiar. Një vlerësim gjithëpërfshirës dhe i besueshëm i sistemit të sigurimit të depozitave kundrejt Parimeve Bazë identifikon pikat e forta dhe të dobëta të një skeme sigurimi depozitash dhe i orienton autoritetet vendimmarrëse drejt masave ligjore përmirësuese. Projekti i vetëvlerësimit është i një rëndësie thelbësore për Agjencinë, duke marrë parasysh se rezultatet e tij përcaktojnë stadin aktual në të cilin operon institucioni si dhe drejtimet kryesore strategjike që duhet të ndërmerren, me qëllim që të sigurohet përputhshmëri maksimale me standardet e praktikave më të mira në fushën e sigurimit të depozitave. Nga ky projekt, Agjencia u vlerësua në përputhshmëri të lartë në raport me Parimet Bazë.

Në të kaluarën kemi mësuar se pavarësisht objektivave të qarta, proceseve të shpejta të punës apo ekspertizës dhe dedikimit të stafit, asnjë nuk do të mjaftojë pa zhvilluar marrëdhëniet e duhura me partnerë strategjikë brenda dhe jashtë vendit. Për këtë arsye, kemi punuar në këtë drejtim, duke rinovuar marrëveshjen ekzistuese të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, në rolin e saj si Autoritet Mbikëqyrës, të cilin e vlerësojmë si tejet të rëndësishme për të operacionalizuar dhe konsoliduar në nivel teknik bashkëpunimin tonë. Në veçanti, kjo marrëveshje krijon një platformë bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve tona lidhur me ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe rolet respektive në këtë drejtim. Njëkohësisht, si pjesë e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, vijojmë të jemi në kontakt dhe bashkëpunim të pandërprerë me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim shmangien e krizave të mundshme dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.


Zhvillimi i marrëdhënieve të Agjencisë është shtrirë gjithashtu në nivel ndërkombëtar përgjatë këtij viti, ku mund të theksojmë takime bilaterale me autoritete homologe të sigurimit të depozitave, ashtu si dhe pjesëmarrje të ndryshme në forume dhe aktivitete të organizuara nga organizata ndërkombëtare si IADI apo EFDI në të cilat Agjencia aderon. Si anëtarë të Komitetit Rajonal për Evropën në IADI, këtë vit na u besua organizimi i takimit vjetor të këtij Komiteti në Tiranë, si dhe zhvillimi i seminarit teknik që pasoi këtë takim. Ky aktivitet dy ditor i zhvilluar në



Tiranë, rezultoi mjaft frytdhënës, ku patëm kënaqësinë të kishim pjesëmarrës nga gjithë Evropa. Besojmë se kontakte të tilla mundësojnë përafrimin e skemës sonë të sigurimit të depozitave me standardet dhe praktikat bashkëkohore në këtë fushë. Paralelisht, dhe për të njëjtin qëllim, këtë vit kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me fondin e sigurimit të depozitave të Turqisë dhe Italisë. Institucionalizimi i bashkëpunimit me këto autoritete është një hap i rëndësishëm për ASD-në duke marrë në konsideratë profesionalizmin dhe ekspertizën e padiskutueshme që ata kanë në administrimin e skemave të sigurimit të depozitave dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në vendet përkatëse. Vlerësojmë gjithashtu, se ky bashkëpunim është i një rëndësie të veçantë në këndvështrim të prezencës së industrisë bankare të këtyre dy shteteve në sistemin bankar në Shqipëri. Së fundmi, në kuadër të përditësimit me standardet më të larta në fushën e sigurimit të depozitave, gjatë këtij viti kemi rinovuar gjithashtu Marrëveshjen e Mirëkuptimit me Fondin e Kompensimit të Depozitave të Koresë.

Puna jonë gjatë këtij viti është shtrirë gjithashtu në funksion të rolit tonë në ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka. Përkrah Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Bankës së Shqipërisë, kemi punuar për miradministrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe rolin mbështetës të skemës së sigurimit të depozitave në një rast ndërhyrjeje të jashtëzakonshme. Objektivi ynë është në çdo rast stabiliteti i sistemit financiar e bankar në vend. E kaluara na ka treguar, që kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një pune përgatitore efektive për të menaxhuar raste të mundshme krizash financiare, të cilat kanë pasoja të rënda sa ekonomike aq edhe sociale.

Një tjetër komponent kyç i punës tonë ka qenë ndërgjegjësimi i publikut dhe rritja e besimit të tij në skemën e sigurimit të depozitave. Mbetemi të angazhuar në iniciativat tona për edukimin dhe ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të publikut mbi përfitimet e skemës, nëpërmjet prodhimit dhe shpërndarjes së materialeve promociionale pranë institucioneve financiare subjekte të skemës së sigurimit të depozitave, dhe komunikimit me anë të rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të internetit të Agjencisë. Gjithashtu jemi përpjekur të jemi sa më transparentë lidhur me punën dhe veprimtarinë tonë të përditshme, nëpërmjet publikimit të aktiviteteve dhe njoftimeve zyrtare për publikun e gjerë dhe bashkëpunëtorët tanë.



Në mbyllje, nuk mund të lëmë pa përmendur në këtë fjalë hyrëse punonjësit dhe bashkëpunëtorët tanë, pa të cilët nuk do të ishte e mundur puna e mirë dhe zhvillimi i mëtëjshëm i institucionit tonë përgjatë këtij viti. Ato kanë qenë në qendër të projekteve tona dhe kontribues për suksesin e tyre. Për këtë, në të ardhmen do të vijojmë të përqendrohemi në rritjen e gatishmërisë operacionale nëpërmjet investimit tek kapitali njerëzor përmes proceseve të vazhdueshme të mësimin dhe trajnimit. Falënderojmë gjithashtu Këshillin Drejtues, kontributi dhe përkushtimi i të cilit nga ka ndihmuar përgjatë gjithë vitit të realizojmë objektivat tona.

Së fundmi i drejtohem publikut, të cilit i garantojmë se do të vazhdojmë të monitorojmë me kujdes zhvillimet në industrinë financiare dhe do të jemi të mirëpërgatitur për t'iu përgjigjur në kohë të gjitha sfidave që do na sjellë e ardhmja, duke patur si qëllim parësor mbrojtjen e interesave të depozituesve shqiptarë dhe kontribuar maksimalisht në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

Ju faleminderit.

Donald Duraj

Kryetar i Këshillit Drejtues

Genci Mamani

Drejtor i Përgjithshëm






## 1.2. Përmbledhje Ekzekutive.

Në fund të dhjetorit 2019, totali i depozitave në sistemin bankar arriti 1,193 miliard lekë, prej të cilave Agjencia ka detyrimin për kompensim prej 702.8 miliard lekë, apo 1,642,224 depozitues. Vlera e depozitave të sigurueshme në banka që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,141 miliard lekë, çka përfaqëson 95.7 % të totalit të depozitave. Depozitat e sigurueshme të individëve zënë peshën më të madhe të depozitave të sigurueshme, konkretisht rreth 85.6% të tyre, ndërkohë që 14.4% janë depozita të sigurueshme të tregtarëve dhe shoqërive tregtare. Depozitat e sigurueshme në lekë, në fund të dhjetorit 2019, zënë 48.5% të totalit të depozitave të sigurueshme, ndjekur nga depozitat në euro me 45%, dhe depozitat në USD 4.5%, duke ruajtur të njëjtat raporte me një vit më parë.

Ndërkaq, totali i depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit është 8.2 mld lekë në fund të vitit 2019, nga 6.9 mld lekë në vitin e kaluar, me një rritje vjetore të ndjeshme prej 19%. Depozitat e sigurueshme në shoqëritë e kursim-kreditit përbëjnë 98.9% të totalit, me një vlerë prej 8.1 mld lekë, në përfitim të 23,455 depozituesve. Në fund të vitit 2019, depozitat e sigurueshme në monedhë të huaj zënë 17.4% të totalit të depozitave të sigurueshme në shoqëritë e kursim-kreditit, ndërkohë që pjesa e mbetur janë depozita në lekë. Detyrimi për kompensim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit është 6.1 mld lekë, apo 14,482 depozitues.


Fondet e sigurimit të depozitave në banka dhe në shoqëritë e kursim-kreditit janë rritur në mënyrë të qëndrueshme përgjatë vitit 2019. Konkretisht, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka në fund të vitit 2019 është 43.18 mld lekë, me një rritje vjetore prej 4.28 mld lekë ose 11%. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së të ardhurave nga primet e sigurimit, të cilat në vitin 2019 ishin 3.37 mld lekë me një rritje prej 3.16%, si dhe rritjes së të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare, në vlerën 1.08 mld lekë ose 8.1% më shumë se në vitin 2018. Ashtu si dhe vitin e kaluar, këtë vit rritja e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare ka ardhur kryesisht si rezultat i zgjerimit të portofolit në obligacione me maturitet 2 dhe mbi dy vjet. Rritja e qëndrueshme e fondeve të sigurimit të depozitave në banka ka sjellë një rritje të raportit



të mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, në 6.15% në fund të vitit 2019 nga 5.83% në vitin 2018.

Ndërkohë, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, në të njëjtën periudhë, është 124.59 mln lekë, duke shënuar një rritje prej 15.89%. Të ardhurat vjetore nga primet e sigurimit për vitin 2019 ishin 16.49 mln lekë, ndërsa të ardhurat vjetore nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit përgjatë vitit 2019 ishin 1.71 mln lekë, me një rritje prej 2.33%. Së fundmi, raporti i mbulimit për vitin e tretë të funksionimit të skemës së sigurimit për SHKK-të është 2.05%.

Së fundmi, përgjatë këtij viti, Agjencia u angazhua gjithashtu në përmbushjen e funksioneve të ngarkuara nga ligji për administrimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (FNJ), si viti i dytë i derdhjes së kontributeve vjetore nga bankat për këtë fond. Vlera kontabël e FNJ-së në fund të vitit 2019 është 1.303 mld lekë. Totali i kontributit vjetor të parë të paguar nga bankat ishte në shumën 650.33 mln lekë. Mjetet financiare të FNJ-së janë administruar sipas politikës së administrimit të miratuar nga Agjencia dhe Banka e Shqipërisë, si Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.



## **Seksioni 2 - Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe vënia në zbatim e rekomandimeve të saj nga Agjencia.**

Agjencia, në përmbushje të mandatit të saj publik dhe në zbatim të përcaktimeve ligjore të Ligjit nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, raporton në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për veprimtarinë e saj vjetore. Në vijim të raportimit për aktivitetin e saj në vitin 2018, Kuvendi me anë të “Rezolutës për Vlerësimin e Veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për Vitin 2018”, miratuar në datë 08.05.2019, vlerësoi aktivitetin vjetor të institucionit si dhe rekomandoi tre drejtime kryesore në të cilat Agjencia duhej të përqendronte angazhimin e saj për vitin 2019. Përgjatë vitit në raportim, Agjencia përmes iniciativave operacionale dhe partneritetit strategjik ka realizuar rekomandimet e Kuvendit. Në vijim do të gjeni rekomandimet e Kuvendit si dhe masat e ndërmarra nga Agjencia për vënien e tyre në zbatim.

**Rekomandimi 1.** Në zbatim të përcaktimeve ligjore dhe duke marrë në konsideratë kushtet ekonomike dhe sociale të Republikës së Shqipërisë si dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të sigurimit të depozitave të shqyrtojë dhe vlerësojë përshtatshmërinë e treguesve të skemës së sigurimit të depozitave duke përfshirë ndër të tjera: normën e primit të sigurimit, nivelin e mbulimit për depozitat e siguruara, kategoritë e depozitave të sigurueshme dhe atyre të përjashtuara nga sigurimi dhe raportin e synuar të mjaftueshmërisë së fondeve që Agjencia administron;

**Masat e marra nga Agjencia:** Agjencia e Sigurimit të Depozitave, bazuar në rekomandimin e lënë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka ndërmarrë projektin për vlerësimin e skemës së sigurimit të depozitave dhe treguesve të saj. Ky projekt është konsideruar i një rëndësie thelbësore për Agjencinë, duke marrë parasysh se rezultatet e tij përcaktojnë stadin aktual në të cilin operon institucioni, si dhe drejtimet kryesore strategjike që duhet të ndërmerren me qëllim që të sigurohet përputhshmëri sa më e lartë me standardet e praktikat më të mira në fushën e sigurimit të depozitave. Rritja e vazhdueshme e nivelit të përputhshmërisë garanton se Agjencia dhe stafi i saj do të realizojnë me sukses objektivat publikë të skemës duke përmbushur mandatin ligjor. Gjithashtu, vlerësimi i përputhshmërisë së skemës është një proces, i cili duhet të kryhet çdo pesë




vjet nga Agjencia në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 52, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e projektit; duke synuar një shpërndarje sa më efektive të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve operacionale të saj; si dhe duke vlerësuar që realizimi i këtij projekti do të ishte një mundësi për të gjithë stafin e Agjencisë për të zhvilluar më tej njohuritë e tyre, projekti u nda në dy nënprojekte:

(1) Projekti për Vlerësimin e përputhshmërisë së skemës me Parimet Themelore për një Sistem Efektiv të Sigurimit të Depozitave, dhe

(2) Projekti për vlerësimin e përshtatshmërisë së treguesve të skemës së sigurimit të depozitave duke marrë në konsideratë kushtet ekonomike dhe sociale të Republikës së Shqipërisë dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të sigurimit të depozitave. Ky projekt, i cili synon vlerësimin e përshtatshmërisë së treguesve të tjerë të skemës së sigurimit të depozitave, siç janë norma e primit të sigurimit, raporti i synuar i mjaftueshmërisë së fondeve që Agjencia administron, etj., ka nisur të realizohet me asistencën e zyrës FinSac<sup>1</sup> të Bankës Botërore. Në dhjetor 2019 është realizuar faza e parë e projektit, në të cilën janë mbledhur dhe përgatitur të dhënat krahasimore të nevojshme në lidhje me depozitat dhe depozituesit për një periudhë 10 vjeçare (2009-2019), të dhëna të cilat do të shërbejnë për një analizë studimore të treguesve të skemës të sigurimit të depozitave, duke përfshirë normën e primit të sigurimit, nivelin e mbulimit për depozitat e siguruara, kategoritë e depozitave të sigurueshme dhe atyre të përjashtuara nga sigurimi, si dhe raportin e synuar të mjaftueshmërisë së fondeve të Agjencisë. Faza vijuese, e cila do të vazhdojë në muajin Mars 2020, do të synojë hartimin e një metodologjie për vlerësimin dhe llogaritjen e këtyre treguesve, gjithashtu për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre. Projekti parashikohet të përfundojë brenda 6-mujorit të parë 2020.

<sup>1</sup> Financial Sector Advisory Centre – Qendra Këshillimore e Sektorit Financiar, është një zyrë e Bankës Botërore me seli në Vienë, Austri, e cila ofron ekspertizë të pavarur dhe sipas nevojës, asistencë teknike dhe mbështetje për vënien në zbatim të projekteve për vendet Evropiane në zhvillim dhe rajonin e Azisë Qendrore.



Agjencia në bashkëpunim me ekspertë të propozuar nga IADI<sup>2</sup> dhe kontraktuar përmes FSVC<sup>3</sup>, realizoi me sukses projektin e vlerësimit të përputhshmërisë së skemës, me Parimet Themelore për një Sistem Efektiv të Sigurimit të Depozitave<sup>4</sup>. Procesi i përgatitjes dhe vetëvlerësimit me konsulencë të ekspertëve ndërkombëtarë të fushës përfundoi në muajin Nëntor 2019.


Parimet Themelore (16) për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave (Core Principles for Effective Deposit Insurance Systems) u krijuan nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave (International Association of Deposit Insurers - IADI) duke përcaktuar një standard të rëndësishëm në ngritjen dhe reformimin e sistemeve të sigurimit të depozitave. Duke qenë se janë pjesë e Standardeve Kyçe të FSB (Financial Stability Board) për Sisteme të Shëndosha Financiare ato përdoren gjerësisht nga FMN dhe Banka Botërore në Programet e Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP). Një vlerësim gjithëpërfshirës dhe i besueshëm i sistemit të sigurimit të depozitave kundrejt Parimeve Themelore identifikon pikat e forta dhe të dobëta të një skeme sigurimi depozitash dhe i orienton autoritetet vendimmarrëse drejt masave ligjore përmirësuese.

Procesi i vlerësimit të përputhshmërisë së skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri është kryer edhe në vitin 2011 dhe vitin 2013. Raporti vëren, se Agjencia ka bërë një përparim të ndjeshëm në nivelin e përputhshmërisë me Parimet Themelore për skema efektive të sigurimit të depozitave, krahasuar me dy proceset e mëparshme të vlerësimit. Në vlerësimin e vitit 2019, Agjencia në raport me 16 parimet themelore të IADI-t është vlerësuar plotësisht në përputhje dhe gjerësisht në përputhje me 15 nga Parimet Themelore. Sa i takon nivelin të mbulimit për depozitat e siguruar dhe kategorive të depozitave të sigurueshme dhe atyre të përjashtuara nga sigurimi, të cilat përfshihen në Parimin Themelor 8, vlen të theksohet se Agjencia është vlerësuar në përputhje të plotë me Parimet Themelore. Raporti vëren se depozitat e siguruar, të pasiguruar dhe niveli e shtrirja e mbulimit përcaktohen qartë dhe publikisht në Ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar. Bazuar në të dhënat e skemës së sigurimit

<sup>2</sup> International Association of Deposit Insurers-Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave

<sup>3</sup> Financial Services Volunteer Corps – Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare. Projektet e FSVC financohen nga USAID.

<sup>4</sup> Core Principles (CP) for Effective Deposit Insurance Systems të IADI. Këto parime janë standardet e pranuar ndërkombëtarisht për vlerësimin e skemave të sigurimit të depozitave.




të depozitave në Shqipëri, ajo ofron mbulim sipas të cilit pjesa më e madhe e depozituesve nëpër banka janë plotësisht të mbrojtur, duke lënë një pjesë të konsiderueshme të vlerës së depozitave të ekspozuara ndaj disiplinës së tregut, çka është në përputhshmëri të plotë me Parimet Themelore për skema efektive të sigurimit të depozitave.

**Rekomandimi 2.** Të vijojë testimin e sistemit për sa i takon gatishmërisë në rast ngjarje sigurimi, infrastrukturën IT, komunikimin me depozituesit, ashtu si dhe bankën në likuidim dhe bankën agjente të përzgjedhur nga Agjencia për kryerjen e një procesi kompensimi, duke kryer simulime teknike dhe tematike si dhe duke u angazhuar në simulimet ndërinstucionale apo simulime për raste të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim testimin e procedurave operacionale të hartuara në letër;

**Masat e marra nga Agjencia:** Gjatë vitit 2019, Agjencia ka kryer simulime teknike me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit anëtare të skemës, si gjatë procesit të verifikimit në këto subjekte, ashtu edhe në periudha të tjera ndërmjet verifikimeve. Simulimet teknike synojnë të përgatisin të gjithë anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave për të raportuar saktë dhe shpejt skedarët për kompensim, në rast të një ngjarjeje sigurimi. Nëpërmjet këtyre ushtrimeve të simulimit, synohet gjithashtu, të përmirësohet cilësia e të dhënave të depozituesve dhe depozitave që raportohen në sistemin informatik të Agjencisë. Të gjitha këto së bashku, do të sigurojnë kryerjen e shpejtë dhe të saktë të pagesave të kompensimit të depozitave, në rast të një ngjarjeje sigurimi, duke kontribuar në këtë mënyrë në ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar e financiar.

Në vijim të simulimit të kryer në vitin 2018 me njërin prej bankave agjente të përzgjedhura në listën paraprake, gjatë vitit 2019, Agjencia ka kryer takime, trajnime e konsultime me një tjetër bankë agjente. Simulimi me këtë bankë, u krye në javën e parë të muajit nëntor. Është për t'u evidentuar fakti, që ky simulim përfshiu si risi, krahasuar me simulimin e mëparshëm: së pari, simulimin e rasteve të ndryshme të kompensimit të depozitave (simulimi i mëparshëm testoi vetëm kompensimin në cash të depozitave, ndërsa në këtë simulim u krye dhe testimi i pagesave nëpërmjet transfertës bankare), së dyti, simulimin e procesit të ankimit të depozituesve. Ky ushtrim simulimi kishte si qëllim të testonte gatishmërinë e bankës agjente, si dhe të përgatiste



stafin e saj që t'i përgjigjet saktë dhe shpejt një ngjarjeje sigurimi. Në përfundim të këtij ushtrimi simulimi, banka agjente krijoi një panoramë të qartë të të gjithë procesit, duke filluar nga rrjedhshmëria e etapave të tij, tek domosdoshmëria e bashkëveprimit cilësor ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë, si dhe të kohës së nevojshme për secilën fazë të këtij procesi, me qëllim realizimin me sukses të pagesave në një ngjarje të mundshme sigurimi. Gjithashtu, ky simulim ishte mjaft i vlefshëm edhe për të gjitha strukturat organizative të Agjencisë, pasi u nxorën mësimet dhe u zhvilluan diskutime mbi gjetje konkrete, të cilat vlerësohen se do të përmirësojnë aftësitë institucionale të Agjencisë dhe rrisin gatishmërinë e saj për t'u përgjigjur me efektivitet situatave të mundshme në një ngjarje sigurimi.

Pjesë e këtij simulimi, ashtu si edhe në simulimin e vitit 2018, ishte edhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës, në Bankën e Shqipërisë. Përfshirja dhe angazhimi i tij, në transferimin e fondeve për kompensim brenda kohës së nevojshme sipas përcaktimeve në skenarin e ushtrimit të simulimit, konsiderohet element i vlefshëm në koordinimin e gjithë infrastrukturës operationale të një ngjarjeje sigurimi.

Në lidhje me infrastrukturën IT, në funksion të gatishmërisë në rast ngjarjeje sigurimi, Agjencia është në fazën përgatitore për zhvillimin e modulit për automatizimin e procesit të kompensimit (marrëdhënia me bankën agjente, moduli i ankimimit, etj.), për të cilin është konsultuar dhe me ekspertë të fushës.

Gjatë procesit të verifikimit në çdo institucion anëtar të skemës së sigurimit të depozitave, Agjencia i ka kushtuar rëndësi të veçantë informimit të depozituesve përmes trajnimit dhe informimit të punonjësve të bankave dhe shoqërive të kursim-kreditit, si ndërmjetës të saj për një informim sa më të mirë të depozituesve, në lidhje me përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave. Për sa i takon informimit dhe komunikimit me depozituesit, në rast të një ngjarjeje sigurimi, Agjencia ka përgatitur për këtë qëllim një strategji të veçantë. Në këtë strategji janë përcaktuar mjetet dhe metodat që do të përdoren për këtë qëllim.



Duhet theksuar se që nga fillimi i vitit 2019 dhe në vijim, Agjencia ka mbajtur marrëdhënie të ngushta trajnimi, këshillimi dhe informimi me të gjitha shoqëritë e kursim-kreditit, si anëtarët më të reja të skemës së sigurimit të depozitave.


**Rekomandimi 3.** Të thellojë më tej bashkëpunimin me Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar, dhe në veçanti me Bankën e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë rolin kyç të këtij institucioni si autoriteti përgjegjës rregullator dhe mbikëqyrës i sektorit bankar dhe financiar si dhe misionin e përbashkët të të dy institucioneve në drejtim të zhvillimit të një sistemi financiar të shëndetshëm në shërbim të publikut dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së tij.

**Masat e marra nga Agjencia:** Në zbatim të këtij rekomandimi dhe në funksion të përmbushjes së mandatit të saj si administratore e skemës së sigurimit të depozitave, Agjencia:


Ka bashkëpunuar me Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar dhe shmangien e krizave të mundshme financiare. Agjencia ka marrë pjesë rregullisht në të gjitha mbledhjet e këtij forumi duke raportuar për gatishmërinë e saj operacionale, duke u fokusuar veçanërisht tek ecuria e depozitave të siguruara pranë bankave dhe shoqërive të kursim-kreditit (shkk), burimet financiare në dispozicion për kompensimin e depozitave të siguruara në institucionet financiare anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, etj.

Sa i takon bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, në rolin e Autoritetit Mbikëqyrës, ky bashkëpunim ka funksionuar në të gjitha drejtimet institucionale. Ky bashkëpunim përfshin, ndër të tjera, (i) konsultimet në zbatim të kuadrit rregullator dhe ligjor për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka; (ii) ndjekjen dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të shoqërive të kursim kredit, (iii) koordinimin e ndërsjellë për vlerësimin e përputhshmërisë së skemës së sigurimit të depozitave me Parimet Themelore për një Sistem Efektiv të Sigurimit të Depozitave dhe projektit të vlerësimit të treguesve financiarë të skemës; (iv) pjesëmarrjes dhe kontributit në aktivitetet operacionale dhe ato në lidhje me edukimin financiar; etj.






Në funksion të zbatimit të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe duke synuar thellimin e bashkëpunimit institucional me Bankën e Shqipërisë, Agjencia ndërmori nismën për rishikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në fuqi me Autoritetin Mbikëqyrës. Marrëveshja u nënshkrua në muajin Dhjetor 2019 dhe synon zhvillimin e mëtejshëm të skemës së sigurimit të depozitave, mbrojtjen e interesave të depozituesve shqiptarë dhe forcimin e stabilitetit financiar në vend, përmes konsolidimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në nivel teknik dhe operacional mes ASD dhe Bankës së Shqipërisë në rolin e saj si Autoriteti Mbikëqyrës. Gjithashtu, Marrëveshja e Bashkëpunimit mundëson rritjen e efektivitetit në koordinimin e aktiviteteve dhe funksioneve të institucioneve, si dhe shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave në mënyrë të vazhdueshme, për realizimin e objektivave publikë respektive. Në veçanti, kjo marrëveshje vendos urat e bashkëpunimit institucional në nivel operacional ndërmjet të dy autoriteteve lidhur me ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe rolet përkatëse në këtë drejtim. Institucionalizimi i bashkëpunimit midis autoriteteve përfaqëson një hap të rëndësishëm në zbatimin e prioriteteve strategjike të Agjencisë.



### Seksioni 3 – Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri dhe zhvillimet gjatë vitit 2019.


Skema e sigurimit të depozitave është një nga elementët më të rëndësishëm të rrjetit të sigurisë financiare në vend dhe ka përgjegjësinë ekskluzive për sigurimin e detyrueshëm të depozitave të individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare, në të gjithë bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, anëtare të saj. Mandati ligjor i skemës është kompensimi i depozitueseve në rast ngjarjeje sigurimi, si dhe kontributi në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Që prej themelimit të saj, skema e sigurimit të depozitave është zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme dhe të konsoliduar.



*Skema e sigurimit dhe kompensimit të depozitave dhe rrjeti i sigurisë financiare*

Një ndër synimet kryesore të skemës ka qenë plotësimi i vazhdueshëm i parimeve dhe kriterëve themelore të sistemeve efektive të sigurimit të depozitave, të miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Sigurueseve të Depozitave (IADI). Përmbushja e këtij synimi në vite është bërë e mundur nëpërmjet reformave në aspektin ligjor dhe nënligjor të skemës, zhvillimit të infrastrukturës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe bashkëveprimit të ngushtë me subjektet anëtare, grupet e interesit dhe institucionet homologe.

Ky proces do të quhej i paplotë, nëse nuk do të kryheshin vlerësimet periodike të përputhshmërisë së skemës me parimet themelore për siguruesit e depozitave, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Sigurueseve të Depozitave (IADI), dhe në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë. Procesi i vetëvlerësimit të veprimtarisë së Agjencisë, i kryer



në Shtator – Nëntor të vitit 2019, nxori në pah një përmirësim të ndjeshëm të nivelit të përputhshmërisë të skemës me standardet ndërkombëtare.

Zhvillimet në rolin e sigurueseve të depozitave në botë, me qëllim dhënien e kontributit të tyre për ruajtjen e stabilitetit financiar, kanë gjetur zbatim edhe në vendin tonë. Agjencia është mandatuar me ligj të kryejë funksionin e një prej burimeve të financimit të veprimtarisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, nëpërmjet transferimit të fondit të kompensimit të depozitave, për qëllim të zbatimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të reformës ligjore për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, Agjencia është e angazhuar në kryerjen me efikasitet të funksionit ligjor të shtuar për administrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Për kryerjen e këtij funksioni, Agjencia bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë, për investimin sa më efikas të fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe për përshtatjen e akteve nënligjore për këtë qëllim.

Gjatë vitit 2019, skema e sigurimit të depozitave ka vijuar të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, duke përmbushur me rigorozitet veprimtarinë e sigurimit të depozitave të individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare në të gjithë bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, anëtare të skemës. Në përputhje me dinamikën e zhvillimeve të sektorit bankar, për shkak të ndryshimeve strukturore të tij gjatë vitit të kaluar, skema e sigurimit të depozitave ka pësuar ndryshime në anëtarësinë e saj.

Në kuadër të ndryshimeve në subjektet anëtare, Këshilli Drejtues i Agjencisë ka miratuar një sërë vendimesh, me ndikim të drejtpërdrejtë në përbërjen e anëtarësisë të skemës. Konkretisht, me vendimin nr.23, datë 12.07.2019, Këshilli Drejtues revokoi certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Ndërkombëtare Tregtare, për shkak të përthithjes së saj nga Banka Union. Ky vendim erdhi në vijim të vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Union me Bankën Ndërkombëtare Tregtare. Në vijim, Banka Union SH.A. ka mbajtur të veçuara për një periudhë tre-mujore, depozitat e saj nga depozitat e Bankës Ndërkombëtare Tregtare Sh.A.



Gjithashtu, Këshilli Drejtues i Agjencisë me vendimin nr. 21, datë 19.06.2019, vendosi të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën e Kreditit të Shqipërisë SH.A., për shkak të fillimit të procesit të likuidimit vullnetar nga ana e vetë bankës. Ky akt u miratua në vijim të vendimit të Bankës së Shqipërisë për revokimin e licencës së Bankës së Kreditit të Shqipërisë, si pasojë e likuidimit vullnetar.


Gjatë vitit 2019, pati një ndryshim në strukturën aksionare të bankës Societe Generale Shqipëri. Këshilli Drejtues i Agjencisë me vendimin nr. 15, datë 30.04.2019, i dha kësaj banke certifikatën për sigurimin e depozitave me emrin e ndryshuar “Banka OTP Shqipëri SHA”, që është edhe blerësi i aksioneve. Ky vendim u mor në vijim të miratimit nga Banka e Shqipërisë të ndryshimit të emrit nga Banka Societe Generale Shqipëri në Banka OTP Shqipëri.

Përveç ndryshimeve në bankat anëtare të skemës, Këshilli Drejtues i Agjencisë ka vendosur për anëtarësimin e shoqërisë së kursim – kreditit “Tirana Invest Kredit 2000” në skemën e sigurimit të depozitave. Pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për dhënien e licencës, Këshilli Drejtues miratoi vendimin Nr. 3 datë 13.02.2019 për anëtarësimin e “Tirana Invest Kredit 2000” në skemën e sigurimit të depozitave.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve, aktualisht skema e sigurimit të depozitave është përgjegjëse për sigurimin e depozitave në 19 subjekte financiare anëtare, ku përfshihen 12 banka dhe 7 shoqëri kursim-krediti.


### **3.1. Depozitat në sistem.**

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2019 ka siguruar depozitat e depozituesve në 14 banka të sistemit, si dhe në 7 shoqëri kursim-krediti. Viti 2019, ishte viti në të cilin, Banka e Kreditit të Shqipërisë sh.a., me miratimin e Bankës së Shqipërisë, filloi procesin e likuidimit vullnetar i cili përfundoi në datë 19 qershor 2019. Gjithashtu, më 1 gusht 2019 Banka Union sh.a përfundoi procesin e bashkimit me përthithje me Bankën Ndërkombëtare Tregtare. Për rrjedhojë që prej 01 gushtit 2019, numri i bankave që sigurohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave është 12.




Në fund të vitit 2019 totali i depozitave në sistemin bankar ishte 1,193 mld lekë, ndërsa totali i depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit ishte 8.2 mld lekë.

*Totali i depozitave në banka dhe shkk, për fund vitin 2019.*



Agjencia sipas të dhënave për fund vitin 2019 ka detyrimin për kompensimin e 702.8 mld lekë depozitave në banka, apo të 1,642,224 depozituesve; si dhe detyrimin për kompensimin e 6.1 mld lekë depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, apo të 14,482 depozituesve. Në totalin e detyrimeve të Agjencisë, prej 708.9 mld lekë, ndaj depozituesve që kanë vendosur depozitat e tyre në banka dhe SHKK, 99.1% e zë detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë vendosur depozitat e tyre në banka, ndërsa 0.9% është detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë të vendosura depozitat e tyre në shoqëritë e kursim-kreditit.


*Depozituesi në çdo bankë apo në çdo degë të bankës së huaj sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, ndërsa depozituesi në shoqëritë e kursim-kreditit sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 000 000 (dy milionë) lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre.*



### 3.2. Sigurimi i depozitave në banka.

Gjatë vitit 2019, totali i depozitave të sistemit bankar ka patur trend rritës për periudhën më të madhe të tij, me norma të ndryshimit mujor relativisht të ulëta. Në fund të dhjetorit 2019, totali i depozitave në sistemin bankar arriti 1,193 mld lekë. Norma mesatare e ndryshimit vjetor për dhjetë vitet e fundit rezulton 5.9%.


*Ecuria e depozitave të sistemit bankar për fund vitet 2002-2019*




#### 3.2.1. Depozitat e sigurueshme në sistemin bankar.

Në fund të vitit 2019, vlera e depozitave të sigurueshme që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,141 mld lekë, duke përfaqësuar 95.7% të totalit të depozitave. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 5.8%, ndërsa rritja në vlerë absolute është 62.3 mld lekë. Depozitat e sigurueshme përfshijnë depozitat me afat, llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimit, llogaritë e kartave, llogaritë e përbashkëta dhe produkte të tjera të ngjashme.

Depozitat e sigurueshme në lekë, në fund të dhjetorit 2019, zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme prej 48.5%, ndjekur nga depozitat në euro 45%, dhe depozitat në USD 4.5% , duke ruajtur pothuaj të njëjtat raporte me një vit më parë .



*Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të sistemit sipas monedhave në % - 31 dhjetor 2019*




Ecuria e depozitave të sigurueshme në lekë gjatë vitit 2019 ka qenë pozitive në shumicën e periudhës, por normat e ndryshimit mujor kanë qenë relativisht të vogla, dhe vetëm në muajt Prill e Gusht ka patur një rënie relativisht të lehtë. Norma më e madhe e ndryshimit mujor ishte në fund të muajit Dhjetor prej +1.7%. Në këtë periudhë këto depozita arritën vlerën prej 553.8 mld lekë. Depozitat e sigurueshme në valutë në muajin Dhjetor 2019 përbëjnë 51.5% të totalit të depozitave të sigurueshme dhe kundravlera e tyre në lekë ishte 587.6 mld lekë. Norma pozitive e ndryshimit mujor për depozitat në valutë është evidentuar në shtatë muaj të vitit, dhe rritja më e madhe prej 3.25 %, u shënuar në fund të muajit Gusht.

*Sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, shuma e kompensimit paguhet deri në nivelin maksimal të mbulimit, vetëm nëse kalon vlerën prej 100 lekësh.*

*Depozitat për kompensim të sistemit bankar në fund të vitit 2019, arritën 702.8 mld lekë, të cilat përfaqësojnë dhe detyrimin maksimal të Agjencisë kundrejt 1,642,224 depozituesve individë dhe tregtarë e shoqëri tregtare.*




*Ecuria e depozitave të sigurueshme të sistemit sipas monedhave 2010 - 2019*




Në fund të dhjetorit 2019, depozitat e sigurueshme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 443.1 mld lekë (e shprehur në përqindje 38.8% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme), kurse depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 698.3 mld lekë (ose 61.2% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme).

*Struktura e depozitave të sigurueshme për kompensim krahasuar me limitin e mbulimit 2.5 mln-Dhjetor 2019*



- Depozitat e sigurueshme për kompensim deri në nivelin maksimal të mbulimit
- Depozitat e siguruarra të depozituesve që i kanë depozitat deri në nivelin maksimal të mbulimit
- Depozitat e sigurueshme për kompensim mbi nivelin maksimal të mbulimit
- Depozitat e siguruarra të depozituesve që i kanë depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit
- Depozitat e pasiguruara






### 3.2.2. Depozitat e sigurueshme të individëve.

Këto depozita në sistemin bankar më 31 dhjetor 2019 arritën 976.5 mld lekë, dhe përbëjnë pjesën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme, konkretisht 85.6 % të tyre (norma e ndryshimit vjetor ishte 5.9%).


Ndikimin në rritjen vjetore prej 5.9% të depozitave të sigurueshme të individëve, e kanë dhënë depozitat në euro (pesha e tyre 43.6%), të cilat të shprehura në kundërvlerën në lekë u rritën me 7.2%, kurse në monedhën origjinale u rritën me 8.7%. Depozitat në usd (pesha e tyre 4.5%) kanë shënuar rënie vjetore me 4.9%, dhe kundërvlera e tyre në lekë u ul me 4.2%. Në dhjetor 2019, depozitat në monedhë të huaj të shprehura në kundërvlerën në lekë kanë peshën 50.3%, dhe rritja vjetore e tyre ishte 6.1%.

*Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të individëve të sistemit sipas monedhave në %-dhjetor 2019*



Në fund të dhjetorit 2019, depozitat e sigurueshme të individëve në lekë në sistemin bankar arritën shumën prej 485.5 mld lekë, duke përfaqësuar 49.7% të depozitave të individëve, ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar një rritje në vlerë prej 25.8 mld lekë (në përqindje 5.6%).

Ecuria e depozitave të sigurueshme të individëve sipas nivelit të mbulimit ka qënë pothuajse pozitive gjatë vitit, vetëm në prill dhe maj kanë shënuar një rënie të lehtë. Krahasuar me fundin




e vitit 2018, depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë janë rritur me 4.7%, kurse depozitat me shuma mbi nivelin e mbulimit janë rritur me 35.2 mld lekë ose 6.8%. Meqenëse në dhjetor 2019, depozitat mbi nivelin e mbulimit kanë peshën më të madhe kundrejt totalit të depozitave të sigurueshme të individëve (56.5 %), ecuria në rritjen e tyre ka ndikuar në rritjen vjetore me 5.9% të depozitave të sigurueshme të individëve.

Numri i depozituesve individë që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave në sistemin bankar, në fund të vitit 2019 është 2,522,482<sup>5</sup>.

Ndër depozituesit individë me depozita më të mëdha se 100 lekë, 94% prej tyre ose 1,434,747 depozitues, i kanë depozitat deri në nivelin e mbulimit dhe përfitojnë mbulim të plotë nga skema e sigurimit të depozitave.

Depozituesit individë me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë në fund të dhjetorit 2019, janë 95,974 dhe shuma e depozitave të tyre arriti vlerën 551.4 mld lekë.


*Ecuria e numrit të depozituesve individë të klasifikuar sipas nivelit të mbulimit 2010-2019*



<sup>5</sup> Numri total i depozituesve është përcaktuar duke mbledhur të dhënat e agreguara të raportuara nga çdo bankë, kështu që një person i cili ka depozita në disa banka është regjistruar disa herë. Në këtë numër ka depozitues me balancë zero deri në 100 lek (minimumi ligjor për kompensim), të cilët në dhjetor 2019 janë 991,761.




*Ecuria e depozitave të sigurueshme dhe të siguruara të individëve 2010-2019*



3.2.3. Depozitat e siguruara të individëve.


Depozitat e siguruara të individëve për sistemin bankar në fund të dhjetorit 2019 ishin në vlerën 665 mld lekë dhe përbëjnë 68.1% të vlerës së depozitave të sigurueshme të individëve.

*Ecuria e depozitave të siguruara të individëve në vlerë dhe ndryshimi vjetor në % 2010 – 2019*







*Ecuria e depozitave të siguruara të individëve në vlerë gjatë vitit 2019*



Për periudhën 2010-2019, përqindja e depozitave të individëve me vlerë deri në 2.5 mln lekë, varion nga 40% deri në 44% të totalit të depozitave të sigurueshme.

*Ecuria e depozitave të individëve të klasifikuara sipas nivelit të mbulimit 2010-2019*






#### 3.2.4. Depozitat e sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare.


Për sistemin bankar, këto depozita në dhjetor 2019 arritën 164.9 mld lekë dhe gjatë vitit u rritën me 5.2%. Depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë u rritën me 10.9%, por pesha e tyre kundrejt totalit depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare ishte 11%, kurse depozitat me shuma mbi 2.5 mln lekë (me peshë 89%), u rritën me 4.5%.

Sipas llojit të monedhës, ndikimin më të madh në rritjen vjetore prej 4.5% të depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare, e kanë dhënë depozitat në euro, të cilat në dhjetor 2019 zënë peshën 53.6 % kundrejt totalit të depozitave të tyre. Norma e ndryshimit vjetor për depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lekë ishte 8.1%. Depozitat në lekë zënë një peshë prej 41.4% dhe u rritën me 4.8% krahasuar me një vit më parë, ndërsa depozitat në USD zënë një peshë prej 4.7%, dhe krahasuar me një vit më parë këto depozita të shprehura në kundërvlerën në lekë u ulën me 14.9%.

*Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare të sistemit sipas monedhave në % - dhjetor 2019*




Sipas kategorisë së produkteve, peshën më të madhe të depozitave të sigurueshme për depozituesit tregtarë e shoqëritë tregtare e zënë llogaritë rrjedhëse, me 87%.



*Struktura e shumës së depozitave të siguroshme të tregtarëve & shoqërive tregtare sipas produkteve - dhjetor 2019*

Shuma në 000 /lekë




Në ndryshim nga situata e depozitave të siguroshme të individëve, 89% e depozitave të tregtarëve e shoqërive tregtare janë me shuma mbi nivelin e mbulimit, dhe u korrespondojnë 7,918 depozituesve, të cilët përfaqësojnë 5% të depozituesve tregtarë e shoqërive tregtare. Kjo strukturë ka qenë pothuajse në këto raporte gjatë gjithë vitit 2019.

### 3.2.5. Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare

Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare gjatë vitit 2019 u ulën me 0.2% dhe në fund të këtij viti arritën vlerën prej 37,8 mld lekë. Ecuria e depozitave të siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare gjatë vitit 2019, ka qenë pozitive për shtatë muaj të vitit.

*Ecuria e depozitave të siguruara të tregtarëve & shoqërive tregtare në vlerë gjatë vitit 2019*






### 3.3. Sigurimi i depozitave në SHKK.


Depozitat në SHKK gjatë vitit 2019 kanë pësuar një rritje prej 19%, krahasuar me një vit më parë dhe 96% krahasuar me 01 janarin e vitit 2017, që është dhe fillimi i aktivitetit të SHKK-ve si anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Ritmet e rritjes mujore të depozitave kanë qënë nga 0.1% deri 2.8%.


*Ecuria e depozitave të SHKK-ve gjatë vitit 2019*



Totali i depozitave të SHKK-ve, në fund të vitit 2019 arriti në 8.2 mld lekë, nga 6.9 mld lekë që ishte në fund të dhjetorit 2018, duke shënuar një rritje vjetore prej 19%. Ndërsa në fillimin e aktivitetit të SHKK-ve si anëtare të skemës së sigurimit të depozitave (janar 2017) kjo shumë ishte 4.1 mld lekë.

*Ecuria e depozitave të SHKK-ve gjatë periudhës Janar 2017- Dhjetor 2019*





### 3.3.1. Depozitat e sigurueshme në SHKK.


Këto depozita në fund të dhjetorit 2019 janë 8.1 mld lekë dhe zënë 98,9% të totalit të depozitave, kundrejt 6.9 mld lekë që ishin më datë 31 dhjetor 2018. Këto depozita i përfitojnë 23,455 depozitues të SHKK-ve, kundrejt 21,564 depozituesve që përfitonin nga skema e sigurimit të depozitave më datë 31 dhjetor 2018.

*“Depozitat e sigurueshme në SHKK, përfshijnë depozitat me afat si dhe llogaritë mbështetëse të depozituesve/anëtarëve të SHKK-së.”*


Depozitat e sigurueshme në fund të dhjetorit 2019, janë rritur me 19% krahasuar me fundin e dhjetorit 2018 dhe 97% krahasuar me 01 janarin 2017, siç mund të vërehet në dy grafikët e mësipërm.

Në rritjen vjetore të depozitave të sigurueshme ndikim më të madh ka patur rritja e depozitave në lekë. Depozitat në lekë zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme të SHKK-ve. Rritja vjetore e tyre është 18,2 %.

*Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme sipas monedhave në % - 31 dhjetor 2019*









Depozitat në monedhë të huaj zënë 17.4% të totalit të depozitave të sigurueshme, si rezultat i faktit që vetëm një pjesë e SHKK-ve kanë depozita në valutë. Në fund të dhjetorit 2019, depozitat e sigurueshme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 3.1 mld lekë (e shprehur në përqindje 39% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme), kurse depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 5 mld lekë (ose 61% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme).

*Struktura e depozitave të sigurueshme për kompensim krahasuar me limitin e mbulimit 2 mln-Dhjetor 2019*




- Depozitat e sigurueshme për kompensim deri në nivelin maksimal të mbulimit
- Depozitat e sigurueshme për kompensim mbi nivelin maksimal të mbulimit
- Depozitat për kompensim të depozituesve që i kanë depozitat deri në nivelin maksimal të mbulimit
- Depozitat për kompensim të depozituesve që i kanë depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit
- Depozitat e pasiguruara



### 3.3.2. Depozitat e siguruar në SHKK.


Në fund të vitit 2019, depozitat e siguruar në SHKK janë 6.1 mld lekë. Kjo shumë përbën 74% të totalit të depozitave, ose 75% të depozitave të sigurueshme.

*Ecuria e depozitave të siguruar sipas tremujorëve gjatë vitit 2019*




Depozitat e siguruar që mbulohen plotësisht nga skema e sigurimit të depozitave, (të gjitha depozitat midis 101 lekë dhe 2 mln lekë) në 31 dhjetor 2019, arritën vlerën 3.1 mld lekë dhe përbëjnë 39% të totalit të depozitave të sigurueshme. Shuma e vlerësuar për sigurim për këto depozita, është e njëjtë me depozitat e siguruar plotësisht.


Depozitat e siguruar që mbulohen pjesërisht nga skema e sigurimit të depozitave, (depozitat më të mëdha se 2 mln lekë) arritën vlerën 5 mld lekë në 31 dhjetor 2019, dhe përbëjnë 61% të totalit të depozitave të sigurueshme. Shuma e vlerësuar për sigurim për depozitat që sigurohen pjesërisht është 3 mld lekë, dhe përbën 59% të totalit të depozitave të siguruar pjesërisht dhe 36% të totalit të depozitave të sigurueshme.




*Ecuria e depozitave të siguruara përkundrejt totalit të depozitave të sigurueshme sipas nivelit të mbulimit për tremujor*




*Ecuria e depozitave të siguruara sipas nivelit të mbulimit për tremujor*






Numri i depozituesve që i kanë depozitat deri 2 mln lekë në fund të dhjetorit 2019 është 13,014. Këta depozitues përbëjnë 90% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave. Numri i depozituesve që i kanë depozitat në vlerën mbi 2 mln lekë në fund të dhjetorit 2019 është 1,468, dhe këta përbëjnë 10% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema.

*Numri i depozituesve të siguruar gjatë vitit 2019 për tremujor*



### 3.4. Procesi i verifikimit të subjekteve anëtare të skemës.


Gjatë vitit 2019 Agjencia, kreu verifikimet në të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Këto verifikime u kryen në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe kishin në fokus së pari, raportimin e saktë dhe brenda afateve të vendosura nga Agjencia, të skedarëve për simulim/kompensim, për prodhimin e listë pagesës me paraqitjen unike të depozituesve. Nga verifikimi i procesit të ngarkimit të këtyre skedarëve u konstatuan probleme të ndryshme, për adresimin e të cilëve u lanë rekomandime me afate të përcaktuara, si bankave ashtu edhe shoqërive të kursim-kreditit. Agjencia do të ndjekë me kujdes në vijim plotësimin e këtyre rekomandimeve, duke mbajtur parasysh rëndësinë e saktësisë së raportimit të këtyre skedarëve për plotësimin e objektivit kryesor të Agjencisë, kompensimin e depozituesve në rast të një ngjarjeje kompensimi. Rëndësi të veçantë në raportimin e këtyre skedarëve ka cilësia e të dhënave të depozituesve. Bazuar mbi rëndësinë dhe problematikat e dala nga verifikimi dhe



raportimi i subjekteve, Agjencia është duke punuar me projektin “Platforma strategjike e përmirësimit të cilësisë së të dhënave për depozitat dhe depozituesit”. Kjo platformë synon që të përmirësojë cilësinë e të dhënave të depozituesve duke vendosur afate dhe parametra të caktuar, veçanërisht adresimin e mungesës së numrit personal, mungesa e të cilit është problematike në funksion të plotësimit të objektivave të Agjencisë.

Një tjetër çështje e rëndësishme, në fokus gjatë procesit të verifikimit, është dhe verifikimi i saktësisë së llogaritjes së primit. Verifikimet e kryera kanë ndihmuar në një raportim të saktë të të dhënave të depozitave dhe depozituesve, për një llogaritje të saktë të detyrimit tremujor të subjekteve të siguruar për krijimin e fondit për kompensim, në rast ngjarjeje sigurimi.

Agjencia, gjatë verifikimit në subjektet anëtare ka në vëmendje gjithashtu, informimin e publikut nga subjektet anëtare të skemës. Një publik i mirëinformuar dhe i ndërgjegjësuar në lidhje me përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave, ka një efekt pozitiv në një ngjarje të mundshme kompensimi, duke ndihmuar në stabilitetin financiar të vendit. Agjencia, nisur nga sa më sipër, verifikon trajnimin që i bëhet stafit të punonjësve me klientelën, si përcjellësit e parë dhe më të rëndësishëm të informacionit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave. Për një informim sa më të mirë dhe më të saktë, Agjencia ka përgatitur një material trajnues për punonjësit e shërbimit me klientët të subjekteve anëtare, mbi bazën e të cilit bëhet informimi i depozituesve. Gjithashtu janë verifikuar kontratat e depozitave, fletëpalosjet e depozitave, si dhe faqja e internetit e subjekteve anëtare, në lidhje me informacionin e detyrueshëm për depozituesit në lidhje me sigurimin e depozitave. Rekomandimet e lëna me afate të përcaktuara për t’u plotësuar, në lidhje me detyrimet ligjore për informim, kanë sjellë një përmirësim të dukshëm të punës për informimin e depozituesve.




## Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të Agjencisë.

### 4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka.

#### 4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka.

Në 31 dhjetor 2019, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 400 milion lekë dhe fitimet e akumuluarua ndër vite, është 43.18 miliard lekë. Në krahasim me një vit më parë ky fond është rritur me rreth 4.28 miliard lekë ose 11.0%. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e fondit të sigurimit të depozitave për periudhën 2009 – 2019.


*Fondi i sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)*



#### 4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka.


Madhësia e fondit të sigurimit të depozitave në banka përcaktohet nga të ardhurat neto nga aktiviteti ndër vite. Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në banka, janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.

Në përputhje me Ligjin “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, duke filluar nga viti 2015, primi i sigurimit të depozitave përllëgaritet në baza tremujore dhe jo më vjetore. Për bankat primi tremujor i sigurimit përllëgaritet si 0.125% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruar, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm,




dhe për SHKK-të primi tremujor i sigurimit përlllogaritet si 0.075% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në SHKK në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Primi tremujor i sigurimit për subjektet anëtare të skemës së sigurimit paguhet jo më vonë se data 15 e muajit të parë të tremujorit për të cilin paguhet.


Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2019 ishin 3.37 miliard lekë ose 3.16% më të larta se në vitin 2018. Të ardhurat nga primet e sigurimit përgjatë periudhës 2009 – 2019 kanë qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e depozitave të siguruara në sistemin bankar në këto vite.



Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2019 ishin 1.08 miliard lekë ose 8.1% më shumë se në vitin 2018. Ky zë të ardhurash përgjatë periudhës 2009 – 2013 ka qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me zgjerimin e mjeteve financiare nën administrim dhe normat e interesit të titujve. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare për vitet 2014-2017 janë ndikuar nga ulja e normave të interesit të titujve të Qeverisë Shqiptarë. Në vitin 2018 dhe 2019, rritja e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare ka ardhur kryesisht si rezultat i zgjerimit të portofolit në obligacione me maturitet 2 dhe mbi dy vjet. Pavarësisht tendencës në rënie të normave të interesit, kthimi nga investimi ka qëndruar në nivele të kënaqshme si rezultat i diversifikimit të portofolit në disa maturitete.




*Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)*




4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka.

Në fund të vitit 2019, depozitat e siguruara në sistemin bankar ishin 702.80 miliard lekë ose 5.34% më të larta se një vit më parë. Rritja e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka dhe ecuria më e moderuar e depozitave të siguruara në sistemin bankar gjatë periudhës 2009 – 2019 kanë sjellë një rritje të vazhdueshme të raportit të mbulimit gjatë këtyre viteve. Në fund të vitit 2019, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 6.15%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruara në sistemin bankar dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2009 – 2019. Për herë të parë, në fund të vitit 2019, raporti i mbulimi arriti në nivelin 6.15 % të depozitave të siguruara që nga krijimi i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

*Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruara në banka (në mijë lekë)*








## 4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në SHKK.

### 4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.

Në përputhje me Ligjin 'Për sigurimin e depozitave', i ndryshuar, në Janar të vitit 2015, u arkëtua nga Buxheti i Shtetit fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK në vlerë 76 milion lekë. Ky fond, siguroi bazën fillestare financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK. Duke nisur nga viti 2015 e në vazhdim, Agjencia ka administruar mjetet financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, të cilat hynë në skemë në Janar 2017. Në 31 dhjetor 2019, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 76 milion lekë, dhe fitimet e akumuluar, është rreth 124.59 milion lekë duke shënuar një rritje prej 15.89% krahasuar me vitin 2018.


*Fondi i sigurimit të depozitave në SHKK (në mijë lekë)*



### 4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.


Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në banka janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, subjektet të cilat u pranuan për të hyrë në skemë nga Janari 2017, filluan të derdhin primet tremujore të sigurimit. Ndërkohë gjatë vitit 2018 subjektet e përfshira në skemë kanë derdhur shtesë kontributi fillestar në vlerën 474 mijë lekë, pas verifikimeve të kryera nga Agjencia. Gjatë vitit 2018 ka derdhur kontributin fillestar edhe një shoqëri kursim-krediti e cila u bë anëtare e skemës së sigurimit në 13 Shkurt 2019.




Meqenëse SHKK-të janë të reja në skemën e sigurimeve, ku viti 2019 është viti i tretë i funksionimit të skemës së sigurimit për këto shoqëri, po paraqitet informacion në lidhje me ecurinë e treguesve financiarë për gjatë vitit 2019 si edhe krahasimin me dy vitet e mëparshme.

*Ecuria e primeve tremujore të sigurimit të depozitave në SHKK (në mijë lekë)*




Të ardhurat nga primet e sigurimit për të gjithë vitin 2019 ishin 16.49 milion lekë. Këto të ardhura nga tremujori në tremujor kanë ardhur në rritje përgjatë vitit 2019, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e depozitave të siguruara në këto shoqëri për këtë vit.


*Primet e sigurimit në SHKK (në mijë lekë)*



Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK përgjatë gjithë vitit 2019 ishin në shumën 1.71 milion lekë, e cila krahasuar me vitin 2018 është rritur me 2.33 %.





*Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK (në mijë lekë)*



Ndërsa për sa i takon ecurisë së raportit të mbulimit të depozitave në këto shoqëri përgjatë tre viteve të funksionimit të skemës, evidentohet në grafikun më poshtë. Në fund të vitit 2019, depozitat e siguruar për SHKK-të ishin rreth 6.1 miliard lekë ose 17.56% më të larta se një vit më parë. Në fund të vitit 2019, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në shkk në krahasim me depozitat e siguruar, ishte 2.05%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruar në shkk-të dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2017 – 2019.

*Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruar në SHKK (në mijë lekë)*







#### 4.3. Administrimi i mjeteve dhe burimeve financiare.

Më 31 Dhjetor 2019, mjetet financiare të Agjencisë, me vlerë nominale 42.81 miliard lekë, janë të investuara të gjitha në tituj të Qeverisë Shqiptare, në depozita një javore ose gjendje në llogari pranë Bankës së Shqipërisë dhe bankës kujdestare Raiffaisen Bank International. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, Agjencia në përputhje me politikën e investimit në fund të vitit 2019 kishte 19.30 për qind të portofolit në instrumente shumë likuid, si depozita dhe llogari rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë dhe në disa banka ku Agjencia mban llogari për aktivitetin operacional si edhe tituj me maturitet të mbetur deri në 90 ditë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas transheve të investimit më 31 Dhjetor 2019.


*Mjetet financiare sipas transheve të investimit*



Mjetet financiare të Agjencisë janë në masën më të madhe në lekë. Agjencia mban edhe një pjesë të mjeteve të saj financiare në valutë Euro. Në përputhje me Politikën e Investimeve, investimet në monedhe të huaj përbëjnë 6.7 % të mjeteve financiare nën administrim, dhe në planin afatgjatë synohet afrimi i strukturës sipas monedhës për portofolin e Agjencisë me atë të depozitave të siguruar. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas valutës më 31 Dhjetor 2019.




*Mjetet financiare sipas valutave*



Në grafikun që vijon paraqitet shpërndarja e mjeteve financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim më 31 Dhjetor 2019. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, mjetet financiare kanë një shpërndarje të shkallëzuar sipas kohëzgjatjes deri në maturim. Pas miratimit të Ligjit nr. 53/14 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, Agjencia ka zhvendosur rreth 58% të portofolit të saj të investimit në instrumente me maturitet të mbetur nga 3- 24 muaj dhe rreth 23% të portofolit të saj në instrumente me maturitet të mbetur mbi 24 muaj.

*Mjetet financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim*





#### 4.3.1. Marrëveshjet për shërbimin e kujdestarisë dhe ndërmjetësimin të titujve në monedhë të huaj.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave në zbatim të kërkesave të Rregullores për Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare, me qëllim diversifikimin e portofolit të saj dhe përafrimin me strukturën e depozitave në sistem, mban një pjesë të mjeteve të saj monetare në monedhë të huaj, përkatësisht në monedhën euro. Ky objektivi përforcohet edhe nga fakti që linja e kredisë me BERZH, e cila siguronte mjete financiare në monedhën euro në rast nevojë, ka përfunduar. Në pamundësi për investimin e mjeteve financiare në valutë brenda vendit, Agjencia gjatë vitit 2019 punoi intensivisht për vendosjen e marrdhënieve të bashkëpunimit me institucione financiare me aktivitet ndërkombëtar për shërbimin e kujdestarisë së titujve dhe të ndërmjetësimin në tregjet ndërkombëtare. Bashkëpunimi u konkretizua me nënshkrimin e marrëveshjes së kujdestarisë me Raiffaisen Bank International AG në Tetor 2019 si edhe me marrëveshjen e ndërmjetësimin me ERSTE Group Bank AG në Dhjetor 2019.

Të dy institucionet e përzgjedhura nga Agjencia kanë një vlerësim “investment grade” (vlerësim ndërkombëtar i borxhit afatgjatë), nga agjencitë e specializuara të vlerësimit, operojnë me seli në Vjenë, janë të licensuara dhe mbikqyren nga Banka Qëndrore Evropiane dhe Autoriteti i Tregut Financiar në Austri si edhe kanë një eksperiencë të gjerë në ofrimin e shërbimeve të kujdestarisë dhe ndërmjetësimin.

Raiffaisen Bank International AG, në kuadër të marrëveshjes së kujdestarisë siguron blerjen e titujve kundrejt pagesës në tregjet ndërkombëtare, ruajtjen dhe raportimin periodik të tyre si edhe mbajtjen e llogarisë rrjedhëse në valutë për qëllime investimi në tregjet e huaja.

Erste Group Bank AG i ofron Agjencisë qasje të drejtpërdrejtë në tregjet financiare rajonale dhe ndërkombëtare (akses në pothuajse 20 tregje financiare) për blerjen e titujve në valutë.

Me ngritjen e infrastrukturës së nevojshme, Agjencia në muajin Dhjetor, investoi me sukses shumën prej 5.47 milion euro në eurobondin e Qeverisë Shqiptare me maturim 7 vjeçar (Tetor 2025) dhe planifikon të vijojë me investime të tjera në valutë.



#### 4.3.2. Marrëveshja e huasë me BERZH.

Ligji “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar, në përputhje me parimet themelore dhe praktikën më të mira në fushën e sigurimit të depozitave, i jep mundësinë Agjencisë për t’iu drejtuar burimeve të ndryshme financiare më qëllim garantimin në çdo kohë të përmbushjes së detyrimeve të saj. Një ndër instrumentet më të rëndësishëm në dispozicion të Agjencisë është e drejta për të marrë hua. Në fund të vitit 2014, Agjencia nënshkroi një marrëveshje huaje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për një linjë kredie deri në 100 milion EUR. Marrëveshja e huasë është shoqëruar me një garanci të Qeverisë Shqiptare. Sipas marrëveshjes, Agjencia ka paguar një komision angazhimi vjetor për këtë instrument, sa 0.5% e shumës në dispozicion nga linja e kredisë. Me rritjen graduale të fondit, Agjencia ka reduktuar vit pas viti shumën në dispozicion të linjës së kredisë, si rezultat i rritjes së mbulimit të fondit të akumuluar ndaj totalit të depozitave të siguruar në sistem. Edhe gjatë vitit 2019, Agjencia ka reduktuar shumën e kredisë nga 35 milion euro në 12 milion euro duke filluar nga 1 Korrik 2019. Me njoftimin nga EBRD për përfundimin e afatit kontraktual të marrëveshjes, Agjencia përfundoi marrëveshjen e kredisë në muajin Korrik 2019. Ministria e Financave, në cilësinë e garantuesit, u informua dhe mori dijeni në lidhje me uljen dhe përfundimin e afatit kontraktual të marrëveshjes së kredisë.




## **Seksioni 5 – Angazhimi me depozituesit dhe partnerët.**

Plani strategjik 2018-2020 përcakton tre prioritete strategjike për Agjencinë në periudhën afatmesme. Njëri prej tyre është zhvillimi strategjik i partneritetit me institucionet partnere, subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, agjencitë homologe dhe depozituesit. Partneriteti dhe bashkëpunimi vlerësohet se është një burim i cili duhet shfrytëzuar në maksimum me qëllim krijimin e një mjedisi sa më efikas nga pikëpamja operationale dhe sa më të sigurtë nga këndvështrimi i besimit të depozituesve dhe publikut. Duke marrë në konsideratë që performanca dhe suksesi i Agjencisë ndikohen pashmangshmërisht nga ndërveprimi me të gjithë partnerët, përgjatë vitit 2019 i është kushtuar rëndësi e veçantë angazhimit me të gjithë grupet e interesit, përfshirë depozituesit, institucionet homologe, autoritetet rregullatore, etj. Në lidhje me këta të fundit, Agjencia, në zbatim edhe të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë shfuqizoi marrëveshjen ekzistuese të vitit 2002 dhe nënshkroi një marrëveshje të re bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë. Kjo marrëveshje është referuar në Seksionin 2 “Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe vënia në zbatim e rekomandimeve të saj nga Agjencia”. Aktivitetet dhe iniciativat e përshkruara në vijim i referohen ndërveprimit me partnerët, grupet e interesit dhe depozituesit në drejtim të rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit për skemën e sigurimit të depozitave dhe bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar duke synuar përfitimin nga eksperiencat më të mira.

### **5.1. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut.**


Ndërgjegjësimi i publikut mbi skemën e sigurimit të depozitave (përfitimet dhe kufizimet e skemës) si dhe rolin dhe funksionet e Agjencisë e Sigurimit të Depozitave si institucioni i vetëm i sigurimit të depozitave në vend, është konsideruar si element shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për përmbushjen e objektivave publike të Agjencisë. “Plani Strategjik i Agjencisë për vitet 2018-2020” dhe “Strategjia e ndërgjegjësimit të publikut” janë materialet bazë mbi të cilat udhëhiqet puna për ndërgjegjësimin e publikut. Duke pasur parasysh që ndërgjegjësimi i publikut është një angazhim afatgjatë, i cili kryhet në mënyrë të vazhdueshme, Agjencia ka monitoruar perceptimet dhe qëndrimet e publikut dhe ka vlerësuar nivelin e ndërgjegjësimit të tij, duke iu referuar të dhënave të marra nga studimet dhe anketimet periodike. Në këtë këndvështrim, Agjencia edhe gjatë vitit 2019 ka vijuar aktivitetin e saj në marrëdhënie me






publikun, duke kombinuar me efektivitet dhe në praktikë mjetet dhe metodat e informimit, komunikimit dhe edukimit, për të arritur në nivelin e dëshiruar të ndërgjegjësimit.

**Faqja zyrtare e Agjencisë** është kanali më gjithëpërfshirës i informimit të depozituesve apo publikut të interesuar për skemën e sigurimit e depozitave dhe Agjencinë. Faqja ofron informacion dhe të dhëna mbi subjektet anëtare të skemës (bankat dhe shkk-të), rolin dhe funksionet e ASD-së, vendimmarrjet e Këshillit Drejtues, publikime dhe njoftime të ndryshme në interes të publikut, etj. Përgjatë vitit 2019 Agjencia ka vazhduar ti kushtojë një rëndësi të veçantë faqes zyrtare të internetit, duke e përditësuar dhe pasuruar në kohë reale dhe në mënyrë transparente me të gjitha informacionet, njoftimet dhe aktivitetet që kanë lidhje me veprimtarinë e Agjencisë dhe përbëjnë interes për publikun. Faqja zyrtare e Agjencisë është pasuruar edhe me rubrika të reja si “Buxheti”, “Vendimmarrja e Këshillit Drejtues”, “Regjistri i Prokurimeve Publike”, etj., rubrika të cilat ofrojnë një gamë akoma edhe më të gjerë informacioni se vitet e kaluara. Njëkohësisht të interesuarit mund të konsultojnë faqen zyrtare për t’u njohur me marrëveshjet, takimet apo pjesëmarrjet e rëndësishme në të cilat institucioni ynë përfaqësohet dhe që i shërbejnë objektivave të Agjencisë për zhvillimin e bashkëpunimit me institucione dhe organizata ndërkombëtare si dhe shkëmbimit të eksperiencave.



Që sistemi i sigurimit të depozitave të jetë efektiv është thelbësore që publiku të informohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me transparencë lidhur me tiparet e skemës së sigurimit të depozitave. Në këtë kuadër Agjencia zbaton parimin e transparencës dhe llogaridhënies nëpërmjet publikimit të materialeve të nevojshme për publikun në përgjithësi dhe depozituesit në veçanti, si dhe ka rritur aksesin publikut në informacionin e saj me një menu specifike “Programi i




Transparencës”. Informacioni i bërë publik në këtë rubrikë, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Agjencisë, akteve të saj rregullative, mirëqeverisjen e Agjencisë, etj.

**Pjesëmarrje në fushata të edukimit financiar** përmes leksioneve të hapura me studentë të Universiteteve. Prej 4 vitesh Agjencia e Sigurimit të Depozitave jep mbështetjen dhe kontributin e saj në aktivitetet e zhvilluara në Javën e Parasë, organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Javë Globale e Parasë është një festë mbarë botërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë financiarisht.



Informimi dhe edukimi i brezit të ri ka qenë gjithmonë kryefjala e punës në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut ndaj skemës së sigurimit të depozitave. Kështu, në aktivitetet që u zhvilluan përgjatë një jave 25-31 Mars 2019, nën sloganin “Tepër i ri për të folur me lekë të vjetër”, Agjencisë iu mundësua të jetë më afër studentëve për t’i informuar dhe orientuar në mënyrën e duhur si depozitues të së tashmes dhe së ardhmes. Agjencia zhvilloi leksion të hapur me studentët e degës financë-bankë në Universitetin e Shkodrës. Gjithashtu Agjencia ofroi simbolikisht mbështetjen e saj financiare në vlerësimin dhe motivimin e mësuesve të cilët kishin përgatitur nxënësit e klasave VI të shkollave 9-vjeçare që u vlerësuan me çmime në konkursin “Mëso! Kurse! Fito”!



**Komunikimi dhe ndërveprimi me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave** është prioritet për Agjencinë. Ai orientohet në dy drejtime:

1. Rritja e nivelit të njohurive të punonjësve të subjekteve anëtare për skemën e sigurimit të depozitave.
2. Bashkëpunimi me subjektet anëtare për promovimin e skemës së sigurimit të depozitave.


Punonjësit e bankave dhe shkk-ve konsiderohen si partnerët strategjikë të Agjencisë në promovimin jo vetëm të produkteve të tyre, por edhe në promovimin e skemës së sigurimit të depozitave. Ato janë në shërbim të drejtpërdrejtë dhe në kontakt me depozituesit, dhe kanë rol të rëndësishëm në ofrimin e informacionit të saktë dhe të qartë depozituesve. Agjencia mbështet subjektet anëtare të skemës për trajnimin e personelit të tyre dhe matjen e niveleve të informimit dhe edukimit të tyre. Punonjës të trajnuar mirë, me njohuri të thelluara mbi elementët e skemës, mund t'i përgjigjen pyetjeve të depozituesve, të ofrojnë informacione të personalizuar për grup kategoritë e depozituesve (sipas nivelit arsimor, grup moshës, shumës së depozitës, etj.) si dhe të ofrojnë optionet e duhura, duke ndihmuar në rritjen e besimit të depozituesve në skemë. Nga ana tjetër, rritja e nivelit të edukimit të Menaxherëve të Drejtimit të subjekteve anëtare, ndihmon në përmirësimin e bashkëpunimit institucional, rritjen e cilësisë së raportimit dhe plotësimin të detyrimeve ndaj skemës. Gjatë vitit 2019 u realizuan takime periodike me përfaqësues të bankave dhe shkk-ve si dhe trajnime në ambientet e bankave me punonjësit e FIBANK dhe Union Bank.

Në legjislacionin e Agjencisë parashikohet që **Agjencia kryen veprimtari promionale**, me qëllim informimin dhe edukimin e publikut. Edhe gjatë vitit 2019, Agjencia ka shpërndarë falas materiale publicitare të saj si fletëpalosje informuese për bankat dhe shoqëritë e kursim kreditit dhe etiketa me logo të ASD-së, me synimin që të japim informacion sa më të qartë, të kuptueshëm dhe transparent për depozituesit.

Në vijim të aktivitetit promociional, këtë vit u prodhuan edhe dy **video edukative promociionale** me tematikë “Rëndësia e të dhënave të sakta të depozituesit” dhe “Shkk-të anëtare të skemës së sigurimit të depozitave”. Duke pasur parasysh problematikat e evidentuara në bashkëpunimet me bankat dhe shkk-të, videot japin informacion dhe edukojnë depozituesit e



tyre dhe publikun me çështje që kanë rëndësi aktualisht. Videot janë shfaqur në faqen zyrtare të Agjencisë ([www.asd.gov.al](http://www.asd.gov.al)), në profilin e saj në facebook si dhe kanalën youtube të Agjencisë.



## 5.2. Bashkëpunimi me institucione të sistemit bankar dhe financiar në vend.

Bashkëpunimi me institucione të sistemit bankar dhe financiar në vend është tepër i rëndësishëm për Agjencinë për mbrojtjen e interesave të depozituesve, forcimin e besimit ndaj skemës së sigurimit dhe rrjedhimisht në kontributin e stabilitetit financiar në vend. Agjencia ka bashkëpunuar institucionalisht në kuadër të pjesëmarrjes në Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar me të gjitha autoritetet e përfshira në këtë forum. Gjithashtu, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, si Autoriteti Mbikëqyrës i Agjencisë, si dhe përditësimit të këtij partneriteti institucional me ndryshimet ligjore në funksionet e të dy institucioneve, u rinovua marrëveshja e bashkëpunimit, për të cilën është raportuar në Seksionin 2 të këtij Raporti. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndihmon në shkëmbimin e informacioneve të ndërsjella, në kohë dhe me transparencë si dhe siguron përputhshmërinë e informacionit që përcillet në publik nga burime të ndryshme. Gjatë vitit 2019 në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe industrisë bankare për një zhvillim të qëndrueshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave organizoi konferencën e saj të tretë me temë “Zhvillimi i qëndrueshëm dhe roli i bankave”, konferencë në të cilën Agjencia e Sigurimit të Depozitave u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Genci Mamani.



### 5.3. Bashkëpunimi rajonal.

Gjatë periudhës në raportim, Agjencia ka qenë mjaft e angazhuar në zbatimin e protokolleve të bashkëpunimit me agjenci homologe të rajonit. Ky bashkëpunim ka rezultuar i frytshëm në drejtim të shkëmbimit të informacioneve dhe njohurive, si në forumet e përbashkëta rajonale ashtu edhe në takimet dypalëshe apo vizitat me karakter studimor, duke marrë dhe në konsideratë ngjashmërinë institucionale dhe operacionale të institucioneve rajonale të sigurimit të depozitave.

#### 5.3.1. Takimi i 7-të rajonal i EFDI Ballkan.

Institucionet e sigurimit të depozitave të Ballkanit, anëtare të Forumit Evropian të Sigurimit të Depozitave me qëllim nxitjen e një bashkëpunimi më të frytshëm përmes takimeve dhe shkëmbimit të eksperiencave kanë nënshkruar në Mars 2016 një Marrëveshje shumëpalëshe



Bashkëpunimi. Në kuadër të kësaj Marrëveshje autoritetet e sigurimit të depozitave të Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë organizojnë takime shumëpalëshe, me qëllim diskutimin dhe shkëmbimin e përvojave dhe sfidave me njëri tjetrin. Në vijim të kësaj tradite tashmë të konsoliduar të këtyre takimeve, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, mori pjesë në takimin e 7-të rajonal të EFDI Ballkan, i organizuar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave të Bosnjë dhe Hercegovinës. Në këtë takim, pjesëmarrësit ndanë zhvillimet e fundit në skemat e tyre të sigurimit të depozitave dhe sfidat respektive. Ndër të tjera, u diskutuan ndryshimet e fundit strukturore në Bosnje dhe Kroaci, zhvillimet e fundit lidhur me një ngjarje kompensimi në Mal të Zi, roli i sistemeve IT në një proces kompensimi, ushtrimet e simulimit si teste të rëndësishme për gatishmërinë operacionale të skemës së sigurimit të depozitave, etj.



### 5.3.2. Vizita në Tiranë e Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës.

Në vijim të bashkëpunimit të konsoliduar dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit nënshkruar mes Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës (FSDK), në muajin tetor 2019 u zhvillua një takim pune mes kolegëve të dy agjencive, kryesuar nga drejtuesit e tyre, Znj. Arijeta Neziraj Elshani, Drejtore e Përgjithshme e FSDK dhe Z. Genci Mamani, Drejtor i Përgjithshëm i ASD si dhe stafeve respektive.

Takimi kishte për qëllim shkëmbimin e eksperiencave lidhur me çështje që kanë të bëjnë me auditimin e brendshëm, implementimin e udhëzimeve EBA për primet me bazë risku dhe për “stress testing”, verifikimin e bankave anëtare të skemës (saktësia e të dhënave për përlllogaritjen e primit) si dhe auditimin e jashtëm të software-it të përlllogaritjes së primit.



### 5.3.3. Vizita në Fondin e Sigurimit të Depozitave të Malit të Zi.

Bazuar në marrëdhëniet dypalëshe dhe Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet autoriteteve të sigurimit të depozitave të rajonit të Ballkanit (Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia) në muajin Mars 2019, përfaqësues të stafit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave të kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm, zhvilluan një vizitë pune në Fondin e Sigurimit të Depozitave të Malit të Zi.

Qëllimi i vizitës së punës ishte përfitimi nga eksperiencia më e fundit që homologët e Malit të Zi kishin pasur në lidhje me kompensimin e një banke të vënë në likuidim të detyruar, nga Banka Qendrore e Malit të Zi. Ky ishte kompensimi i parë i realizuar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Malit të Zi, proces i cili filloi në fund të muajit janar 2019.





Gjatë kësaj vizite u shkëmbyen eksperiencia me punonjësit e Fondit të Sigurimit të Depozitave të Malit të Zi lidhur me problematikat dhe mësimet e nxjerra nga ky proces. Krahas diskutimit të këtij rasti konkret, u shkëmbyen informacione në drejtim të përgatitjeve për adresimin në kohë të sfidave të mundshme në një ngjarje sigurimi, si edhe marrjen e masave për ndërhyrjen sa më të shpejtë për zgjidhjen e tyre, duke marrë në konsideratë strukturat e ngjashme operationale të të dy autoriteteve si dhe mjedisin pothuajse të njëjtë financiar.

Drejtuesit e të dy institucioneve u angazhuan të thellojnë më tej bashkëpunimin dhe veçanërisht në funksion të pjesëmarrjes së ndërsjellët në situata të mundshme kompensimi.



#### **5.4. Bashkëpunimi ndërkombëtar.**

Agjencia gjatë vitit 2019, në zbatim të politikave të saj është angazhuar në drejtim të bashkëpunimit me autoritetet e sigurimit të depozitave dhe kontributit në forumet ndërkombëtare të shoqatave ku është anëtarësuar. Fokusi kryesor i këtij angazhimi ka qenë shkëmbimi i eksperiencave me qëllim përfitimin nga praktikat më të mira në fushën e sigurimit të depozitave si një nga mjetet për rritjen e kapaciteteve profesionale të Agjencisë.

##### **5.4.1. Pjesëmarrja në forumet ndërkombëtare.**

Agjencia e Sigurimit të Depozitave është nga anëtarët e para të forumeve ndërkombëtare të sigurimit të depozitave. Pjesëmarrja në këto forume krijon mundësinë e informimit në kohë me ndryshimet në mjedisin rregullativ duke lehtësuar punën e Agjencisë në ngritjen dhe mbajtjen e kuadrit të saj rregullator në linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare. Nga ana tjetër, institucionet ndërkombëtare financiare gjithashtu ofrojnë mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave profesionale, të cilat kanë një rëndësi gjithnjë e më të madhe në kushtet e ndryshimeve të vazhdueshme në tregjet financiare dhe në pritshmëritë e shoqërisë në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave. Në mbështetje të aspiratave të Shqipërisë për anëtarësim në



Bashkimin Evropian, një rëndësi parësore merr shkëmbimi i eksperiencave bashkëkohore dhe harmonizimi i kuadrit rregullator të skemës së sigurimit të depozitave me praktikat dhe standardet më të mira Evropiane dhe ndërkombëtare.


Në këtë kuadër, Agjencia gjatë vitit 2019 ka marrë pjesë në takimet vjetore të organizuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave (IADI) dhe Forumi Evropian i Siguruesve të Depozitave (EFDI). Kjo e fundit, EFDI, zhvilloi mbledhjen vjetore si dhe konferencën



ndërkombëtare me temë “Sigurimi i Depozitave në Europë – Ridzenjimi i Hartës”, në Sarajevo, Bosnjë-Hercegovinë, në të cilën mori pjesë edhe një delegacion i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Në këtë konferencë morën pjesë personalitete të skemave evropiane të sigurimit të depozitave, ekspertë financiarë të institucioneve ndërkombëtare, të ftuar nga Banka Qendrore Evropiane, akademikë, etj. Paneli hapës i konferencës përfshinte përfaqësuesit e skemave të sigurimit të depozitave të Ballkanit dhe trajtonte tematikën e harmonizimit të kuadrit të tyre rregullator me EU *Acquis* në funksion të aspiratave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Pjesë e panelit ishte dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, Z. Genci Mamani. Në prezantimin e tij, Z. Mamani, vuri në dukje se legjislacioni për administrimin e skemës së depozitave në Shqipëri është në pjesën më të madhe në përputhje me Direktivën e Komisionit Evropian për skemat e garantimit të depozitave. Ai gjithashtu, renditi sfidat me të cilat do të përballet Agjencia për të arritur një përputhshmëri të plotë me kuadrin rregullator financiar Evropian, për të cilat shprehu angazhimin e plotë të Agjencisë.

Së fundmi, Agjencia ka dhënë kontributin e saj në mbledhjet e Komiteteve Rajonale të IADI-t dhe Komiteteve tematike të EFDI-t. Duke vlerësuar kontributin dhe rolin e Agjencisë në kuadër të strukturave të saj, IADI përzgjodhi për herë të parë Agjencinë të organizojë në këtë vit takimin vjetor të Komitetit Rajonal të Evropës, në të cilin morën pjesë pothuajse të gjitha institucionet e





sigurimit të depozitave të Evropës por dhe më tej sigurues depozitash nga e gjithë bota. Gjatë këtij aktiviteti të zhvilluar në Tiranë, u organizua dhe një seminar teknik me temë “Planet e Kontigjencës dhe Menaxhimi i Krizave/Rastet e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”. Aktiviteti dy ditor rezultoi mjaft frytdhënës dhe besojmë se kontakte të tilla rrisin ekspozimin e skemës sonë të sigurimit të depozitave ndaj faktorëve të jashtëm dhe për rrjedhojë mundësojnë përditësimin e saj sipas standardeve dhe praktikave bashkëkohore në këtë fushë.


#### 5.4.2. Takimi i Komitetit Rajonal të Evropës dhe seminari teknik në Tiranë.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI) organizoi mbledhjen e Komitetit Rajonal të Evropës (Europe Regional Committee-ERC) të IADI-t si dhe seminarin teknik me temë “Planet e Kontigjencës dhe Menaxhimi i Krizave/Rastet e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”, në muajin Prill 2019.



Komiteti Rajonal i Evropës (KRE) është komiteti më i madh rajonal të IADI-t duke qenë se në të marrin pjesë pothuajse të gjitha institucionet e sigurimit të depozitave të Evropës. Në mbledhjen e KRE, e cila organizohet për herë të parë në një vend jo anëtar të Bashkimit Evropian, u diskutuan zhvillimet më të fundit rajonale dhe në juridiksione të veçanta sa i takon sigurimit të depozitave. Gjithashtu, temë e diskutimeve ishte dhe roli i KRE dhe aktivitetet përkatëse në funksion të Objektivave Strategjikë të IADI-t. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij aktiviteti, takimi vjetor i KRE u përshëndet dhe nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Gent Sejko.

Aktiviteti i organizuar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në të cilin merrnin pjesë 70 përfaqësues nga 28 juridiksione të ndryshme, vazhdoi me seminarin teknik në lidhje me “Planet e Kontigjencës, Menaxhimin e Krizave dhe Rastet e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”. Qëllimi



kryesor i seminarit teknik ishte diskutimi i thelluar i Parimeve Themelore për Skema Efektive të Sigurimit të Depozitave 6 dhe 14 të IADI-t duke eksploruar proceset dhe politikat e nevojshme, që i duhen një skeme të sigurimit të depozitave për hartimin e një Plani Kontigjence, duke përdorur mjetet dhe burimet e duhura për të përballuar në mënyrë efektive një krize të mundshme financiare si edhe rastet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Gjatë dy ditëve të seminarit teknik pjesëmarrësit patën mundësinë, përmes sesioneve teorike dhe praktike, të njiheshin dhe diskutonin me prezantimet dhe rastet studimore të ekspertëve nga Bordi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (BNJ) të Bashkimit Evropian, Qendra Këshillimore e Sektorit Financiar të Bankës Botërore dhe institucione homologe nga Kanadaja, Kroacia, Greqia, Italia, Kosova, Holanda, Polonia, Rumania, Rusia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

#### 5.4.3. Marrëveshjet e Bashkëpunimit.

Plani Strategjik i Agjencisë për periudhën 2018-2020 identifikon bashkëpunimin ndërkombëtar me institucionet homologe si një nga iniciativat strategjike në kuadër të prioritetit për zhvillimin strategjik të partneritetit. Plani afatmesëm përcakton se Agjencia duhet të konsiderojë lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritete të sigurimit të depozitave të atyre vendeve evropiane, industria bankare e të cilave është e pranishme përmes filialeve në sistemin bankar shqiptar. Në këtë drejtim Agjencia përgjatë vitit 2019 i përqendroi përpjekjet e saj në nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Italisë dhe Turqisë.



Këto marrëveshje ofrojnë një vlerë të shtuar, si në drejtim të shkëmbimit të informacioneve në rastet e ngjarjeve të sigurimit në institucionet bankare mëmë të anëtarëve të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, por gjithashtu edhe në drejtim të konsultimeve dhe bashkëpunimit për



përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, sa i takon disiplinës së sigurimit të depozitave, ndër të tjera. Për më tepër, duke marrë në konsideratë funksionin që i është dhënë Agjencisë me Ligjin 133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë" si administruese e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, marrëveshja me autoritetet e sigurimit të depozitave të Italisë dhe Turqisë merr një rëndësi të veçantë në drejtim të rritjes së kapaciteteve operacionale, duke qenë se me mandat ata janë edhe autoritetet i ndërhyrjes së jashtëzakonshme në juridiksionet përkatëse.

Gjithashtu, duke vlerësuar ecurinë e suksesshme të marrëdhënieve dypalëshe përmes vizitave të ndërsjella, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave profesionale, Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe Fondi i Sigurimit të Depozitave të Koresë rinovuan Marrëveshjen ekzistuese të Bashkëpunimit dhe për një periudhë 5 vjeçare. Angazhimi i autoriteteve të sigurimit të depozitave të Shqipërisë dhe Koresë do të vazhdojë me qëllim adoptimin e praktikave më të mira në disiplinën e sigurimit të depozitave si nja nga elementët thelbësorë të stabilitetit financiar.



#### 5.4.4. Shkëmbimi i eksperiencave me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Ukrainës.

Në muajin Qershor 2019, një delegacion nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) vizitoi Fondin e Sigurimit të Depozitave të Ukrainës (DGF) në Kiev. Gjatë kësaj vizite, u zhvilluan takime me drejtues, si dhe përfaqësues të departamenteve kryesore të DGF të Ukrainës, të cilët prezantuan përvojën e tyre të gjerë në drejtim të administrimit të ngjarjeve të sigurimit, kuadrin rregullator të fondit, si dhe funksionimit të infrastrukturës të teknologjisë së informacionit.

Nga këto takime, anëtarët e delegacionit morën një informacion të vlefshëm, i cili mendojmë që i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë punës në Agjenci, në drejtim të zhvillimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të skemës, si në nivel organizativ ashtu edhe operacional, veçanërisht për zgjerimin e spektrit të zgjidhjeve teknike që duhet të mbahen në vëmendje për përmbushjen me sukses të objektivit institucional për kompensimin e depozitave të siguruar.



## Seksioni 6 – Mirëqeverisja e organizatës

Agjencia e Sigurimit të Depozitave është një institucion publik themeluar në vitin 2002 që ushtron aktivitetin në bazë të Ligjit nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar. Agjencia gëzon pavarësi operationale dhe financiare nga çdo subjekt tjetër, në zbatim të dispozitave të Ligjit “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.

Strukturat qeverisëse të Agjencisë dhe proceset e punës sigurojnë vënien në zbatim të strategjive të miratuara dhe administrimin e riskut në të gjitha aspektet e aktivitetit të institucionit. Kontrollat e brendshme përfshijnë, ndër të tjera, kodin e etikës, deklarimet e konfliktit të interesit, ndarjen e detyrave, etj. Këshilli Drejtues i Agjencisë luan një rol të rëndësishëm në vendosjen dhe ruajtjen e një sistemi efikas të menaxhimit të riskut dhe kontrolleve të brendshme, duke i kushtuar rëndësi të veçantë etikës, kulturës së punës dhe standardeve operationale.

Sic përcaktohet në Ligj, Agjencia raporton në Kuvend, në Këshillin e Ministrave dhe në Autoritetin Mbikëqyrës për veprimtarinë vjetore të saj. Shërbimi i auditit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për vitin 2019 është kryer nga kompania PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (IPPF).

### 6.1. Këshilli Drejtues

Bazuar në Ligin “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar dhe Statutin e Agjencisë organi më i lartë drejtues është Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Autoriteti Mbikëqyrës. Dy anëtarë propozohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë dhe një anëtar propozohet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë jo ekzekutivë, me përfshirje të anëtarit që emërohet në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm. Ligji “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, përcakton se afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Drejtues është pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje, bazuar në treguesit e performancës të veprimtarisë së tyre.



Gjatë vitit 2019 Këshilli Drejtues i Agjencisë nuk ka pasur ndryshime dhe përbërja e tij është si më poshtë.

KËSHILLI DREJTUES	FUNKSIONI	INSTITUCIONI PROPOZUES
Donald Duraj	Kryetar	Banka e Shqipërisë
Genci Mamani	Anëtar	Banka e Shqipërisë
Erjon Luçi	Anëtar	Ministri i Financave
Ervin Mete	Anëtar	Ministri i Financave
Nexhmije Çela	Anëtar	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)

Bazuar në detyrimin që në çdo kohë të veprojnë me ndershmëri në interesin më të mirë të Agjencisë, anëtarët e Këshillit Drejtues ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar, Statutin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Rregulloren “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” dhe legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale.


Procesi i vendimmarrjes i Këshillit Drejtues, përgjatë vitit 2019, është udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës. Këshilli Drejtues në vitin 2019 e ushtroi aktivitetin e tij përmes organizimit të mbledhjeve me frekuencë të përmuajshme. Vendimmarrja e Këshillit Drejtues ka prodhuar 39 vendime në funksion të vendosjes dhe ruajtjes së standardeve të larta në mirëqeverisjen e Agjencisë si dhe konsolidimin e kapaciteteve të saj për të përmbushur mandatin ligjor. Vendimmarrja e Këshillit u përqendrua kryesisht në miratimin e akteve nënligjore me qëllim miradministrimin dhe zgjerimin e skemës së sigurimit të depozitave si dhe mbarëvajtjen operacionale të Agjencisë.



## 6.2. Struktura organizative

Struktura organizative e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave", i ndryshuar.

Bazuar në Statutin e Agjencisë miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018 dhe në zbatim të strukturës së saj organizative Agjencia organizohet në mënyrë hierarkike, drejtohet nga Këshilli Drejtues dhe administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Sipas kësaj strukture Agjencia është e përbërë nga 7 sektorë, dhe ka në total një staf prej 29 punonjësish. Gjatë vitit 2019 stafi ka pasur një qëndrueshmëri të vazhdimësisë së tij, në vijim kjo edhe të politikave të saj për motivimin profesional të tyre. Struktura organizative e Agjencisë gjatë vitit 2019 nuk ka pësuar ndryshime.







## Seksioni 7 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019.

**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania shpk  
Rr. Elbasanit  
Rruga "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja  
Nr.7, 1010,  
Tirana, Albania  
Tel: +355 4 45 17 920  
Fax: +355 4 45 17 990  
www.deloitte.al

### RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Drejtuar Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,**

**Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare**

#### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave ("Agjencia"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondin e sigurimit të depozitave dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2019 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

#### **Baza e Opinionit**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

#### **Informacione të tjera**

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i përgatitur nga Drejtimi i Agjencisë në përputhje me Ligjin Nr. 53/2014, datë 22 maj 2014 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër, kur, të na vihen në dispozicion dhe, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.



Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Agjencisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Agjencisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

### **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të njaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshelje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmeri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Agjencisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Agjencisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Agjencisë për vazhduar në vijimësi.





**Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)**

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Agjencisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k*

Deloitte Audit Albania sh.p.k  
Rruga "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010, Tiranë, Albania,  
Tiranë, Shqipëri  
Numri i identifikimit unik të subjektit (NUIS): E41709002H

Partner Angazhim  
Auditues Ligjor  
Enida Cara

*Enida Cara*

Tiranë, Shqipëri  
27 shkurt 2020



**Pasqyra e pozicionit financiar.**

		Më 31	
	Shënime	Më 31 dhjetor 2019	dhjetor 2018
<b>AKTIVET</b>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	3,035,714,526	5,350,390,547
Investime të mbajtura për të mbledhur flukset e kontraktuara	9	40,212,956,768	33,597,058,369
Aktive afatgjata materiale, neto	10	60,096,842	64,146,294
Aktive afatgjata jo materiale, neto	11	6,201,241	9,327,649
Aktive të tjera, neto	12	4,335,660	3,864,405
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>43,319,305,037</b>	<b>39,024,787,264</b>
<b>DEYRIMET</b>			
Detyrime të tjera	13	6,354,320	10,598,211
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>6,354,320</b>	<b>10,598,211</b>
<b>FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE</b>			
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	14	400,000,000	400,000,000
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në Shoqëri Kursim Krediti ("SHKK")	14	76,000,000	76,000,000
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka		42,788,356,194	38,506,676,717
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK		48,594,523	31,512,336
<b>TOTALI I FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE</b>		<b>43,312,950,717</b>	<b>39,014,189,053</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE</b>		<b>43,319,305,037</b>	<b>39,024,787,264</b>



## Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithpërfshirëse.

Shënime	Viti i mbyllur më	Viti i mbyllur më 31	
	31 dhjetor 2019	dhjetor 2018	
<b>Të ardhura operative:</b>			
Të ardhura nga primet e sigurimit	15	3,392,642,125	3,286,733,568
Të ardhura nga kontributet fillestare	16	-	474,892
Të ardhura nga interesat	17	1,082,420,273	1,001,121,175
Të ardhura të tjera operative	18	1,044,996	632,425
		<b>4,476,107,394</b>	<b>4,288,962,060</b>
<b>Shpenzime financiare:</b>			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(39,878,999)	(230,324,215)
Shpenzime të tjera financiare	19	(12,620,913)	(23,945,556)
		<b>(52,499,912)</b>	<b>(254,269,771)</b>
<b>Shpenzime operative:</b>			
Shpenzime personeli	20	(81,706,506)	(81,708,632)
Shpenzime administrative	21	(35,768,425)	(29,929,770)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	(8,698,863)	(8,949,419)
		<b>(126,173,794)</b>	<b>(120,587,821)</b>
Rimarrje/(Shpenzime) provigjioni mjetet monetare dhe aktivet financiare	8, 9	1,327,975	(1,889,388)
<b>TEPRICA NETO PËR VITIN</b>		<b>4,298,761,663</b>	<b>3,912,215,080</b>
Të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse		-	-
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE</b>		<b>4,298,761,663</b>	<b>3,912,215,080</b>



**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Teprica e fondeve</b>		<b>4,298,761,663</b>	<b>3,912,215,080</b>
<b><i>Rregullime për:</i></b>			
Të ardhura nga interesat	17	(1,082,420,273)	(1,001,121,175)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	8,698,863	8,949,419
Provigjone për aktivet financiare	9	(2,855,979)	4,576,697
Kthim provigjone për aktive financiare njohur ne 1 janar 2018	9	-	(7,336,348)
<b>Ndryshimet në:</b>			
Aktive të tjera		(471,255)	(1,398,820)
Detyrime të tjera		(4,243,891)	182,031
Interesi i arkëtuar		872,079,353	880,259,310
<b>Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ</b>		<b>4,089,548,481</b>	<b>3,796,326,194</b>
<b>AKTIVITETI INVESTUES</b>			
Blerje e pajisjeve	11	(1,523,002)	(9,589,958)
Blerje e letrave me vlerë		(6,402,701,500)	(2,293,584,000)
<b>Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues</b>		<b>(6,404,224,502)</b>	<b>(2,303,173,958)</b>
<b>Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit</b>		<b>(2,314,676,021)</b>	<b>1,493,152,236</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	8	5,350,390,547	3,857,238,311
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit</b>	<b>8</b>	<b>3,035,714,526</b>	<b>5,350,390,547</b>



Pasqyra e ndryshimeve në fondet e sigurimit të depozitave.

	Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK	Totali
<b>Më 1 janar 2018</b>	<b>400,000,000</b>	<b>76,000,000</b>	<b>34,617,089,962</b>	<b>16,220,361</b>	<b>35,109,310,323</b>
Rregullim nga implementimi i SNRF 9 per aktivet financiare	-	-	(7,336,349)	-	(7,336,349)
Teprica neto për vitin	-	-	3,896,923,104	15,291,976	3,912,215,080
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>3,896,923,104</b>	<b>15,291,976</b>	<b>3,912,215,080</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>400,000,000</b>	<b>76,000,000</b>	<b>38,506,676,717</b>	<b>31,512,337</b>	<b>39,014,189,054</b>
Teprica neto për vitin	-	-	4,281,679,477	17,082,186	4,298,761,663
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4,281,679,477</b>	<b>17,082,186</b>	<b>4,298,761,663</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>400,000,000</b>	<b>76,000,000</b>	<b>42,788,356,194</b>	<b>48,594,523</b>	<b>43,312,950,717</b>




## **Seksioni 8 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.**


### **8.1. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.**

Me ligjin nr.133/2016 datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë”, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave i janë caktuar kompetencat për administrimin e këtij fondi. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është kryer në përputhje me Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, miratuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë. Fondi është bërë efektiv duke filluar nga data 1 Janar 2018. Banka e Shqipërisë është Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme që ushtron të drejtat e ndërhyrjes të përcaktuara në Ligj. Banka e Shqipërisë përllëgarit çdo vit kontributin vjetor që sektori bankar do të paguajë për arritjen e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Kontributi vjetor i paguar nga Bankat për vitin e parë ishte në shumën 632.42 milion lekë dhe për vitin e dytë 650.33 milion lekë. Në 31 dhjetor 2019, vlera kontabël e aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme është 1.303 miliard lekë.

Mjetet financiare të Fondit janë investuar në përputhje me strategjinë vjetore të investimit për vitin 2018 dhe 2019, miratuar nga Komiteti i Investimeve i Agjencisë. Këto mjete financiare me vlerë nominale 1.306 miliard lekë në 31 dhjetor 2019 , janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe depozita një javore e llogari rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare të këtij fondi, Agjencia në përputhje me politikën e administrimit të mjeteve financiare në fund të vitit 2019 kishte 31.02 për qind të portofolit në instrumente shumë likuid, si llogari rrjedhëse dhe depozita me Bankën e Shqipërisë, dhe letra me vlerë me maturitet të mbetur deri në 90 ditë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas transheve të investimit më 31 Dhjetor 2019.




*Mjetet financiare sipas transheve të investimit*




Mjetet financiare të FNJ janë në masën më të madhe në lekë. Në përputhje me Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, investimet në monedhë të huaj përbëjnë 5.59 përqind të mjeteve financiare nën administrim. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas valutës më 31 Dhjetor 2019.

*Mjetet financiare sipas valutave*



Agjencia për llogari të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, administrojnë dhe mban llogari të veçanta kontabël për mjetet financiare të këtij fondi. Agjencia përgatit dhe raporton pranë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme portofolin e mjeteve financiare të Fondit si edhe pasqyrat financiare tremujore të tij. Pasqyrat Financiare vjetore të Fondit auditohen nga shoqëri auditimi të çertifikuara e të pavarura.



## 8.2. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019.

**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania shp.k.  
Rr. Elbasanit,  
Rruga "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja  
Nr.7, 1010,  
Tirana, Albania  
Tel: +355 4 45 17 920  
Fax: +355 4 45 17 990  
[www.deloitte.al](http://www.deloitte.al)

### RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

#### Drejtuar Këshillit Drejtues të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

#### Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

##### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2019 si dhe performancën e tij financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

##### Baza e Opinionit


Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

##### Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i përgatitur nga Drejtimi i Agjencisë në përputhje me Ligjin Nr. 53/2014, datë 22 maj 2014 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më sipër, kur, të na vihen në dispozicion dhe, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohej të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.





### **Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Fondit, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabël, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

### **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit.

Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmeri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Fondit për vazhduar në vijimësi.



**Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare (Vazhdim)**

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënime shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Fondit, përveçse çështjeve të tjera, edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania Shpk*  
Deloitte Audit Albania Shpk  
Rruga "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010, Tiranë, Albania,  
Tiranë, Shqipëri  
Numri i identifikimit unik të subjektit (NUIS): L41709002H

Partner Angazhimi  
Auditues Ligjor  
Enida Cara



Tiranë, Shqipëri  
27 shkurt 2020



**Pasqyra e pozicionit financiar.**

	Shënime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
<b>AKTIVET</b>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	255,035,598	66,291,242
Investime të mbajtura për të mbledhur flukset e kontraktuara	9	1,050,529,040	571,698,800
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>1,305,564,638</b>	<b>637,990,042</b>
<b>DEYRIMET</b>			
Detyrime të tjera	10	1,976,995	1,314,609
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>1,976,995</b>	<b>1,314,609</b>
<b>AKTIVET NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME</b>			
Aktivet neto në dispozicion të ANJ		636,675,433	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		666,912,210	636,675,433
<b>TOTALI AKTIVEVE NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME</b>		<b>1,303,587,643</b>	<b>636,675,433</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE I AKTIVEVE NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME</b>		<b>1,305,564,638</b>	<b>637,990,042</b>



**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithpërfshirëse.**

		Që nga data e krijimit	
	Shënim	Viti i mbyllur më 31	(1 Janar 2018 ) deri më
	e	dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Të ardhura operative:</b>			
Të ardhura nga kontributi vjetor	11	650,332,126	632,174,459
Të ardhura nga interesat	12	20,203,798	8,437,388
Të ardhura të tjera operative	13	-	5,712
		<b>670,535,924</b>	<b>640,617,559</b>
<b>Shpenzime financiare:</b>			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(1,543,602)	(2,270,400)
Tarifa dhe komisione bankare	14	(500,000)	(500,000)
		<b>(2,043,602)</b>	<b>(2,770,400)</b>
<b>Shpenzime operative:</b>			
Shpenzime operative nga aktiviteti	15	(1,476,995)	(1,064,425)
		<b>(1,476,995)</b>	<b>(1,064,425)</b>
Shpenzime provigjioni aktivet financiare	8	(103,117)	(107,301)
<b>TEPRICA NETO PËR VITIN</b>		<b>666,912,210</b>	<b>636,675,433</b>
Të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse		-	-
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE</b>		<b>666,912,210</b>	<b>636,675,433</b>



**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Që nga data e krijimit (1 Janar 2018) deri më 31 dhjetor 2018
<b>Teprica neto e Fondit</b>	<b>666,912,210</b>	<b>636,675,433</b>
<i>Rregullime për:</i>		
Të ardhura nga interesat	(20,203,798)	(8,437,388)
<b>Ndryshimet në:</b>		
Detyrime të tjera	662,386	1,314,609
Interesi i arkëtuar	19,373,558	9,738,588
<b>Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ</b>	<b>666,744,356</b>	<b>639,291,242</b>
<b>AKTIVITETI INVESTUES</b>		
Blerje e letrave me vlerë	(478,000,000)	(573,000,000)
<b>Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues</b>	<b>(478,000,000)</b>	<b>(573,000,000)</b>
<b>Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit</b>	<b>188,744,356</b>	<b>66,291,242</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	8 66,291,242	-
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit</b>	<b>8 255,035,598</b>	<b>66,291,242</b>



**Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.**

	Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme	Totali
<b>Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 1 janar 2018</b>	-	-
Teprica neto për vitin	636,675,433	636,675,433
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>636,675,433</b>	<b>636,675,433</b>
<b>Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2018</b>	<b>636,675,433</b>	<b>636,675,433</b>
Teprica neto për vitin	666,912,210	666,912,210
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>666,912,210</b>	<b>666,912,210</b>
<b>Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,303,587,643</b>	<b>1,303,587,643</b>